

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7583 E hënë 9 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

Nisur nga dëshira dhe motivi për t'i shërbyer sa më mirë procesit të mësimdhënies/mësimxënies, arrijtes së standardeve të përparuara bashkëkohore...

Vijon në faqen 20

Nga ZIJA LIKA

MASR të rishikojë normat e punës mësimore në arsimin parauniversitar



**Opinion** **Ditës**

Sa herë ndodhin ngjarje dhe fakte të cilat zgjojnë opinionin publik kam reaguar dhe ndoshta dhe në mënyrë instiktive kam hedhur rreshta, duke u munduar...

Vijon në faqen 21

Nga REZANA KONOMI

Teatri absurd dhe transparenca e munguar e partisë-shtet



Mediat greke raportuan shtyrjen e paktit

## Marrëveshja e detit, dy kryeministrat Rama dhe Cipras takohen të martën në Londër

Basha pesë ditë në Uashington, takime në Departamentin e Shtetit

Kryeministrat e Shqipërisë dhe Greqisë, Edi Rama e Aleksis Cipras pritet të takohen në Londër të martën në kuadër të Procesit të Berlinit, ku do të marrin pjesë vende të Ballkanit Perëndimor dhe vendet kryesore evropiane. Mediat greke shkruajnë se ata do të kenë në fokus të bisedës mes tyre negociatat dhe finalizimin e një...

Në faqet 3-4

## EKSPERTI: SI TE LLOGARISNI MASEN QE PERFITONI KUR MBUSHNI MOSHEN

# GOCI: FORMULA E SAKTE E PENSIONEVE TE PLEQERISE

“Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë të moshuarit për të marrë pagesën dhe koeficientet përkatëse para dhe pas vitit 1994”



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 7

### INTERVISTA



**Vasilika Hysi: Nëse opozita do të djegë mandatet, hapat i parashikon ligji**

Në faqet 2-3

Ylli Merja: Pse duhet ta përdorni susamin gjatë verës

## “Forconi organizmin me vajin e kësaj bime”

Mjeku popullor: 5 këshilla për një zemër të fortë

Nga VOLTIZA DURO

Farat e susamit janë përdorur që në lashtësi, afërsisht 1500 vite para erës sonë, madje në Kinë janë konsumuar 3000 vjet para erës sonë. Ushtarët grekë dhe romakë e përdornin si ushqim përpara luftërave



ose marshimeve të gjata, pasi u jepte shumë energji. Gjithashtu, susami është një ndër bimët e para, vaji i së cilës është përdorur. Farat dhe vaji i susamit kanë cilësi të pazëvendësueshme. Kjo bimë është e këshillueshme të përdoret në...

Suplement

### ÇFARË NDODHI

**Përplasja me armë në diskon në Dhërmi, cila është historia e Emiljano Ninës**

Në faqen 6

### FLET EKSPERTI

**Krimi kibernetik, Besmir Semanaj: Çdo vit dënohen pesë veta, Shqipëria e rrezikuar**

Në faqen 5

### TEATRI KOMBETAR

**Kastriot Çipi: Ku gaboi Elia Zaharia, princesha që thotë se doli kundër princit**

Në faqet 18-19

### QSHA: KUSH PERJASHTOHEJ

**Provimi i licencës, ja 1150 infermierët që do të testohen dhe dokumentet që nevojiten**

Në faqet 8-11

# SITUATA POLITIKE

## INTERVISTA

Negociatat me BE, nënkryetarja e Kuvendit: Nuk duhet të humbim kohë me debate joproductive

Darina Tanushi

**N**ënkryetarja e Kuvendit, deputetja e PS-së, Vasilika Hysi vlerësoi dje në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" se ky është një vit pune për maxhorancën, në pritje të qershorit 2019 për negociatat me Bashkimin Evropian. Nisur nga deklaratat e bëra edhe nga ambasadori amerikan, Donald Lu, për kapjen e "peshqve të mëdhenj", Hysi tha se ai ka qenë konsistent gjithmonë në qëndrimet e tij. Ajo që shqetëson është pandëshkueshmëria për disa krime. Hysi shprehet se edhe reforma zgjedhore po ecën si duhet, por mbetet në pritje të gjetjes së konsensusit me opozitën.

**Znj. Hysi, Këshilli i BE-së caktoi qershorin e vitit 2019 për diskutimin e hapjes së negociatave me Shqipërinë, ndërkohë që ju si maxhorancë prisnit që ato të hapeshin këtë qershor. A ndiheni të zhgënjyer?**

Deri më sot Shqipëria nuk kishte marrë një datë të caktuar për hapjen e negociatave. Është hera e parë që Këshilli Evropian caktoi datën, ndërkohë që Komisionin Evropian që ndjek nga afër reformat në Shqipëri dhe progresin e arritur i rekomandoi Këshillit hapjen e negociatave pa kushte. Unë nuk ndihem e zhgënjyer kur analizoj progresin e bërë dhe nevojën për vazhdimin e reformave, përbërjen si dhe problematikën që më cilat përballat vetë Bashkimin Evropian, për shkak të rritjes së partive politike të djathta dhe presionit që ato u ushtrojnë qeverive të tyre. Ky është një vit skanimi analitik për progresin e bërë dhe nuk duhet të humbim kohë me debate jo produktive, por të vazhdojmë reformat e nisura dhe të bëjmë më të dukshme rezultatet.

**Një nga rekomandimet që janë dhënë për këtë vit parapërgatitor deri në marrjen e një vendimi vitin që vijon është edhe reforma zgjedhore, për të cilën ka kohë që diskutohet, por ende asnjë draft final. A do t'i mbetet sërish minutët së fundi ndryshimi i Kodit?**

Reforma zgjedhore ka filluar tashmë. Komisioni parlamentar për Reformën Zgjedhore është mbledhur në mënyrë të vazhdueshme. Të gjitha rekomandimet e bëra nga OSBE/ODIHR në raportet e vitit 2013, 2015 dhe 2017 janë evidentuar, grupuar sipas fushave dhe tematikave dhe janë marrë një për një në shqyrtim në mbledhjet e Komisionit të Reformës Zgjedhore. Ndryshe nga reformat e tjera zgjedhore, komisioni po ndjek një metodologji që mund të ketë marrë kohë më shumë, por është e dobishme. Ky proces është gjithëpërfshirës dhe për çdo grup rekomandimesh janë zhvilluar seminare, konferenca, konsultime me ekspertë vendas dhe ndërkombëtare, të partive politike, të pavarur, të shoqërisë civile, të OSBE/

# Vasilika Hysi: Opozita të mos sillet pa përgjegjësi, të hapur për konsensus

"Nëse duan të djegin mandatet, ligji parashikon hapat"



Nënkryetarja e Kuvendit, deputetja e PS-së, Vasilika Hysi

ODIHR, Këshillit të Evropës, Komisionit të Venecias dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Gjithashtu, janë zhvilluar seanca dëgjimore dhe janë analizuar raportet dhe rekomandimet e vëzhguesve vendore. Me mblylljen e konsultimeve publike, fillon përgatitja e shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Zgjedhor. Ky proces nuk do të lihet për minutën e fundit, nëse mbajmë parasysh ecurinë e procesit të konsultimeve. Gjithçka do varet nga gjetja e konsensusit mes forcave politike, pasi ndryshimet në Kodin Zgjedhor duhet të jenë konsensuale dhe të votohet me 84 vota.

**Në bazë të këtyre rekomandimeve të Këshillit të BE-së, për një dialog më konstruktiv me opozitën, si do të arrini të lidhni urat e bashkëpunimit gjatë këtij viti?**

Në fakt, për shumë çështje ka pasur përplasje për të arritur konsensus me opozitën. Mjafton të sjell në vëmendjen tuaj dhe të lexuesve që Kodi i Sjelljes së deputetëve u miratua pas 3 viteve pritjeje të konsensusit me opozitën, ndonëse kjo na dëmtoi shumë. E tjetër është e miratimit i Kodit të Sjelljes ishte jo vetëm i nevojshëm, por edhe kusht nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (Greco). Kemi më shumë se një vit, që presim opozitën të vijojë mbledhjet e Këshillit të Legjislacionit për të reflektuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese në ligjet e paketës së reformës në drejtësi, apo përpjekjet e bëra për të arritur konsensus për ngritjen organëve të vetingut.

Mazhoranca është e hapur dhe do të vazhdojë të mundësojë gjetjen e konsensusit me opozitën, por nga ana tjetër, opozita duhet të marrë dhe të përmbushë përgjegjësitë e saj lidhur me integrimin evropian. Deri më sot angazhimi i opozitës të shumë për të dëshiruar.

**A ka një strategji të vetën mazhoranca në Kuvend, përballë bllokimit nga ana e opozitës, të cilën e paralajmëroi sërish kryetari i PD-së?**

Kryetari i opozitës betohet dhe përbotëhet për rolin e tij dhe të opozitës në përmbushjen e detyrimeve dhe krijimin e kushteve për hapjen e negociatave. Kjo sjellje nuk është kontribut, por bllokim i procesit dhe krijim i një imazhi negativ për vendin dhe mbi të

gjitha mosmarrje përgjegjësisë. Kuvendi luan një rol të rëndësishëm në proceset e integritimit evropian jo vetëm mes ushtrimit të funksionit legjislativ dhe atij të kontrollit parlamentar të qeverisjes drejtpërdrejtë dhe mes institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, por edhe me Këshillin të Integritimit Evropian, të cilin e drejton opozita. Nëse duam të bllokojmë këto pro-

### REFORMA ZGJEDHORE

"Ky proces nuk do të lihet për në minutën e fundit, nëse mbajmë parasysh ecurinë e procesit të konsultimeve. Gjithçka do varet nga gjetja e konsensusit mes forcave politike, pasi ndryshimet në Kodin Zgjedhor duhet të jenë konsensuale dhe të votohet me 84 vota", tha nënkryetarja e Kuvendit.

cese, dëmin më të madh ia bëjnë Shqipërisë dhe shqiptarëve si dhe vetes së tyre. Shqiptarët të ndëshkojnë me votë. Mazhoranca do të vazhdojë me përkushtim të përmbushë detyrat e shtëpisë.

**PD ka kërcënuar me djegin e mandateve deri në zhbërjen e Kuvendit. A ndiheni të "kërcënuar" nga ky paralajmërim i opozitës?**

Opozita mund të vendosë vetë çfarë të dojë. Çdo deputet e fiton mandatin e vet falë besimit dhe votës së zgjedhëseve. Nga momenti i fitimit të mandatit, secili prej nesh ka përgjegjësi ta ushtrtojë atë në përputhje me programin dhe në interes të publikut. Opozita është në parlament për të përfaqësuar zgjedhësit e saj dhe të bëjë opozicionin e qeverisjes dhe të ofrojë alternativat me të mira se ato që ofron qeveria. Opozita nuk mund të sillet pa përgjegjësi dhe të vëre interesat e disave, ofqëndre të liderit mbi interesat e zgjedhësit, të publikut dhe të vendit. Nëse duan të djegin mandatet, ligji parashikon hapat ligjore që duhen ndërmarrë.

**Ju ka ndodhur edhe ju,**

sesa më parë, pavarësisht nëse deputeti i përket mazhorancës apo opozitës. Megjithatë, ndryshe nga çfarë thotë rregullorja, ka deputetë që nuk e njohin atë, mund të jenë të rinj ose nuk njohin atë ose edhe kur e njohim, nuk e respektojnë atë. Shpesh rregullorja cenohet për shkak të krijuara për të bllokuar ecurinë normale të seancës plenare ose ka deputetë që duan të tregojnë sesa "besnikë" janë për kryetarin. Situata të tilla kërkojnë qetësi nga drejtuesi i seancës, ligjshmeri, respektim të rregullores së kuvendit, sjellje në vëmendje të deputetit të rregullave që duhet të respektojnë dhe shkeljeve që bën dhe kur ka shkelje, zbatohen sanksionet e parashikuara në Rregulloren. Deri më sot, barra më e madhe i ka rënë kryetarit të Kuvendit dhe më pak muaj. Megjithatë, edhe unë kam pasur momente që duhej t'i menaxhoja me kujdes dhe them se i kam menaxhuar, duke respektuar rregullat edhe ndaj kolegëve të mi të mazhorancës.

**Në një nga deklaratat e fundit të tij, ambasadori i**



kryejnë vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të vogël, por edhe për ata që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe që më shumë për persona të akuzuar janë persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore, funksionarë publikë ose këta të fundit mundësojnë veprimtari kriminale të rrezikshme. Pandëshkueshmëria për disa krime ose për veprat që kryejnë disa subjekte përbën shqetësim. Ndaj një nga objektivat e reformës në drejtësi ishte dhënia fund e pandëshkueshmërisë. Reforma po jep rezultatet e saj. Mjafton t'ju sjell në vëmendje aktionet e suksesshme të policisë në luftën kundër trafikimit të drogës ose pasurimit të parave. Më shumë efikasitet do duhej në hetimin dhe gjykimin e abuzimit me fondet publike dhe luftën kundër korrupsionit. Kjo varet shumë nga sistemi i drejtësisë dhe trajtimit i rasteve të referuara ose të denoncuar. Unë besoj se drejtësia shumë shpejt do të japë më shumë drejtësi.

**Reforma në drejtësi, në këndvështrimin tuaj, si një prej anëtarëve të komisionit të posaçëm, si po vijon? Dua të vë në dukje këtu që ende nuk është krijuar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, nga ana tjetër kemi vakum në Gjykatën Kushtetuese, etj.**

Reforma në drejtësi është shumë e gjerë dhe shumë dimensionale. Një aspekt i saj është miratimi i ligjeve dhe akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve. Shumica e ligjeve të reformës në drejtësi janë miratuar. Ka ende disa ligje në procedurë parlamentare. Ato po i nënshtrohen konsultimit publik dhe me grupet e interesit. Dy ligjet që kanë të bëjnë me statusin e gjyqtarit dhe prokurorisë së sistemit të drejtësisë kanë nevojë të reflektojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i

### "PESHQIT E MËDHENJ"

"Pandëshkueshmëria për disa krime, ose për veprat që kryejnë disa subjekte përbën shqetësim. Ndaj një nga objektivat e reformës në drejtësi ishte dhënia fund e pandëshkueshmërisë. Reforma po jep rezultatet e saj. Më shumë efikasitet do duhej në hetimin dhe gjykimin e abuzimit me fondet publike dhe luftën kundër korrupsionit", u shpreh Hysi.

**gjatë drejtimit të seancës parlamentare që të jetë ndëzuar debati. Sa i vështirë ka qenë menaxhimi i saj?**

Zhvillimi i seancave plenare bazohet në Rregulloren e Kuvendit. Sjellja e deputetëve gjatë seancës rregullohet nga Rregullorja e Kuvendit dhe Kodi i Sjelljes së deputetëve, që është pjesë e rregullores. Me drejtimin e kryetarit të Kuvendit, rregullorja ka filluar të zbatohet shumë më mirë

**SHBA-ve në ikje, Donald Lu foli për dështim të policisë dhe prokurorisë për "peshqit e mëdhenj". Si e gjykonit këtë deklaratë?**

Ambasadori i SHBA-ve, z. Donald Lu ka qenë konsistent në qëndrimet e tij lidhur me efikasitetin e luftimit të krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar dhe korrupsionit në veçanti. Është normale që drejtësia duhet të funksionojë jo vetëm për ata që





← legjislacionit është përgjegjës për të reflektuar vendimet. Sikundër e theksova më lart, ky këshill filloi nga puna, shqyrtoi një pjesë të rekomandimeve, por nuk u mblodh më. Këshilli drejtohet me rotacion dhe radhën e ka përfaqësuesi i opozitës. Reforma ka edhe një aspekt tjetër: hartimin e akteve nënligjore për ligjet e miratuara. Kjo punë po ecën. Misioni Eurarius V dhe misionet të tjera po asistojnë organet përgjegjëse të përbashkët detyrimet. Aspekt shumë i rëndësishëm i reformës që pak për mendet dhe analizohet është miratimi i shumë shtesave dhe ndryshimeve në kode dhe ligje, parashikimi i institutëve të reja që mundësojnë akses më të mirë dhe të shpejt në drejtësi. Do vlerësoja të kishte analiza, vëzhgime dhe studime të pavarura për të parë efikasitetin e tyre dhe për të informuar më mirë publikun. Kështu, ndryshimet e mëdha të bëra në kuadër të reformës në drejtësi nuk njihen sa dhe si duhet dhe nga të gjithë, qofshin edhe profesionistët. Mjafton të sjell në vëmendjen tuaj se në kuadër të luftimit të krimit të organizuar mes goditjes së pasurive që burojnë nga aktivitetet kriminale, ligji i njohur në publik si ligji antimafia ka ndryshuar duke krijuar mundësi që asetet dhe paratë e konfiskuara dhe të sekuestruara të përdoren për kompensimin e viktimave të krimit, për formimin profesional, punësimin dhe mbështetjen e shoqërisë civile që ofron shërbime ndaj viktimave. Rezultati dhe modeli i parë i përdorimit të aseteve të konfiskuara u inaugurua dhe në bashkinë e Fierit me krijimin e një biznesi social që ka punësuar edhe gra-viktima të dhunës.

Reforma në drejtësi ka edhe një aspekt shumë të rëndësishëm, që shpesh mes tyre është vënë shenja e barazimit: rivlerësimi pasurisë, integritetit dhe profesionalizimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Vetingu, pas shumë pengesash dhe vështirësish po ecën më mirë. As-

pekt tjetër i reformës në drejtësi është plotësimi i vendeve vakante në gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese. Në këtë proces janë të përfshirë disa institucione si: Presidenti i Republikës, Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Po e nis nga ky i fundit, pasi është shumë me rëndësi të sqarohet publiku në mes të zhurmës së madhe dhe keqinformimit që bëhet nga opozita dhe media.

Këshilli i Emërimeve në drejtësi është zgjedhur me short në dhjetor 2017. Anëtarët duhet të votohen me përparësi. Një pjesë janë votuar, të tjerë janë në proces. Ka ndonjë që nuk e ka kaluar me sukses këtë proces. Që mblodhet e KED të jenë të mundura duhet 5 anëtarë. KED vlerëson kandidatët për institucionet dhe i rendit. Pra, fillimi sa më parë nga puna e këtij këshilli është me rëndësi. Kjo nuk varet nga parlamenti dhe aq më tepër nga mazhoranca, por ecuria e vetingut. Lidhur me kandidatët për në Gjykatë Kushtetuese, Presidenti i Republikës dhe Kuvendi ka përcjellë kandidataturat për rivlerësimin e tyre me përparësi. Ata janë në proces rivlerësimi. Sapo të votohen, do të procedohet me zgjedhjen e tyre. Lidhur me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Kuvendi ka përbushur detyrimet e tij. Ai ka zgjedhur anëtarët jogjyqtarë dhe joprokurorë për këto organe. Kandidatët gjyqtarë dhe prokurorë për këto këshilla janë duke kaluar procesin e vetingut. Sapo të mbyllet ky proces, këto organe do të ngrihen. Pra, reforma në drejtësi është shumë e gjërë dhe e thellë, komplekse dhe ka hasur shumë pengesa. Ne si mazhorancë jemi të gatshëm të mbështesim ecjen e shpejtë dhe të mirë të saj.

Si Kuvend, jemi në procesin e ngritjes së një komisioni të pavarur për të monitoruar, koordinuar dhe raportuar në Komisionin e Ligjeve dhe në parlament zbatimin e ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Mediat greke raportuan shtyrjen me afat të pacaktuar për paktin

# Negociatat për kufirin detar, Rama takon Cipras në Londër

Dy kryeministrat, të martën në samitin e drejtuar nga Tereza Mei

Kryeministrat e Shqipërisë dhe Greqisë, Edi Rama e Aleksis Tsipras pritet të takohen në Londër të martën në kuadër të procesit të Berlinit, ku do të marrin pjesë vende të Ballkanit Perëndimor dhe vendet kryesore evropiane. Mediat greke shkruajnë se ata do të kenë në fokus të bisedës mes tyre negociatat dhe finalizimin e një marrëveshjeje për kufirin detar. Mediat greke raportuan dhe për një vendim të papritur të kryeministrit Cipras për të shtyrë për një afat të pacaktuar finalizimin e marrëveshjes me Shqipërinë. "Shqipëria dhe Greqia shtojnë për një kohë më të përshtatshme zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe". Kështu shkroi të shtunën gazeta greke "Kathimerini", e cila tha se kryeministri grek po merr pak kohë për të qetësuar ujërat në opinionin publik helen, dallë të cilat janë egërsuar pas marrëveshjes me Maqedoninë. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje të vlerësuar nga Brukseli ka rritur presionin e opozitës greke, e cila kërkoi mbledhje urgjente të Komisionit për politikën e jashtme. "Kathimerini" shkruan se vendimi i Cipras për të shtyrë firmosjen e paktit me Tiranën ka për qëllim shfryrjen e tensioneve të brendshme deri në ratifikimin e plotë të marrëveshjes me Shkupin. Ndërkohë, ekipet negociatore do të vijojnë punën për të ndarë zonën ekonomike ekskluzive. Gazeta greke sjell në vëmendje hezitimin që ka presidenti shqiptar Ilir Meta për të autorizuar nënshkrimin e marrëveshjes, teksa i njeht kryeministrit Rama vullnetin për të ecur përpara me marrëveshjen. Ministria e Jashtme Shqiptare nuk ka dhënë asnjëherë detaje mbi këtë proces, por vetëm ka njoftuar zhvillimin e tri raundeve të bisedimeve, duke nënvizuar klimën bashkëpunuese dhe pozitive të palëve.

Cipras ndodhet në një pozitë të vështirë, pasi reagimet ndaj marrëveshjes së qeverisë Cipras me Maqedoninë për çështjen e emrit kanë qenë të ashpura. Opozita dhe faktorët të tjerë politikë e kanë quajtur tradhti kombëtare. Ndaj kjo sipas analistëve me Greqi e kanë vendosur Athinën zyrtare në një pozicion aspak komod sa



Kryeministrat e Shqipërisë dhe Greqisë, Edi Rama e Aleksis Cipras

## SAMITI

Samiti i vendeve të Ballkanit do të mbledhë në kryeqytetin britanik edhe liderët e tjerë të rajonit për të diskutuar sfidat e përbashkëta. Të martën më 10 korrik, kryeministrit britanike, Tereza Mei do të udhëheqë samitin, i pesti në vazhden e procesit të Berlinit. Pjesë e tij do të jenë kryeministrat e Shqipërisë, Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë.



## Tritan Shehu: Zgjidhja për paktin detar, vetëm në Hagë me mirëkuptim reciprok

Deputeti i Partisë Demokratike, Tritan Shehu, tha dhe se bisedimet me Greqinë kanë rënë në një pikë të vdekur, duke shtuar se zgjidhja e hapësirës detare midis dy vendeve mund të bëhet duke u drejtuar Gjykatës së Hagës. "Bisedimet me Greqinë me gjithë "terrin informativ", duket se kanë rënë në një "pikë të vdekur", gjë që ishte e paralajmëruar nga ne. Diplomacia jonë është në vorbullën e një dështimi të ri. Çdo afat kohor e objektiv i trumbetuar nga Ministria e Jashtme tashmë është tejkaluar pa rezultat. Kjo ndodh se çdo gjë, prej pesë vitesh, po zhvillohet së prapthi, pa profesionalizëm e përgjegjësi nga Rilindja për këto marrëdhënie", u shpreh dhe Shehu. Siopas tij, "Greqia është një demokraci shumë e vjetër, me një diplomaci të konsoliduar, një partner i yni strategjik me të cilin nuk mund të luhet me këto improvizime infantile, kërcënime e më tej lëshime ekstreme, pa stabilitet e besueshmëri. Një politikë e tillë aspak serioze nuk mund të ketë sukses e është e destinuar të dështojë", u shpreh deputeti demokrat. "Ndërsa në lidhje me Marrëveshjen e Kufirit Detar, siç po tregojnë edhe zhvillimet, në këtë krahur të krijuar nga Rilindja ngel vetëm një zgjidhje dinjitoze e racionale për ne, ajo e drejtimin të Gjykata e të Drejtës në Hagë, me mirëkuptim reciprok. Kështu ndodh kur të 'hyn vetja në qejf e kërkoni të bësh cubin një herë e më pas detyrohesh të kthehesh tek roli i 'shërbëtorit' të bindur, por ama dhe ky me dy 'zotërin', gjë që e komplikon edhe më shumë situatën, duke krijuar një tablo tragjiko-komike", tha Shehu.

u takon bisedimeve me Shqipërinë. Qeveria e koalicionit Syriza dhe Greqët e Pavarur kanë pasur përplasje të shoqëruara me reagime të ashpura ndaj Marrëveshjes së Prespës dhe Cipras duket se nuk ka forcën e duhur për të mbështetur një marrëveshje me Shqipërinë, e cila do të shkaktojë reagime të reja, sidomos për të ashtuquajturin Epir i Veriut, një çështje që prej mijëra votues kryesisht në këtë zonë, qytetarë që kanë marrë shtetësi greke. Brenda partisë së Syrizës deputetë të zonës së Epirit kanë shprehur pakënaqësi për reagimet e fundit të ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias se Epiri i Veriut i përket një vendi sovran e të pavarur dhe është qesharake të thuhet se i përket Greqisë.

Por, burime diplomatike bëjnë me dije se kësaj pengese i shtohet dhe pengesa e palës shqiptare. Çelja e negociatave në verën e vitit të ardhshëm nuk sjell nxitje të veçantë për të arritur një marrëveshje mes dy vendeve. Në Greqi ekzistojnë dyshime të forta nëse marrëveshja për demarkacionin e kufijve detarë, do të jetë një pakt ku do të dalin të fituar të dyja palët. Brenda koalicionit qeverisës grek janë vendosur pikëpyetje për parimet dhe dispozitat e Konventës mbi të Drejtën e Detit dhe në veçanti për bazën e llogaritjes së ndikimit të reduktuar të ishujve, marrë shkas nga ishulli i Othonit për mosparranjin e vijës së mesme. Megjithatë, ministri i Jashtëm grek, Kocias është treguar optimist për finalizimin e negociatave brenda verës. Edhe Tirana zyrtare ka pohuar se palët vijojnë diskutimet dhe se ato kanë shënuar progres.

Kryeministri Edi Rama ishte në Vlorë, ku gjatë përpunimit të Impiantit të Përpunimit të Ujërave foli edhe për infrastrukturën në këtë qytet. Ai tha se pasi të jenë përfunduar rrugët bazike të qytetit, investimet do të përqendrohen në brendësi të qytetit, në blloqet e palateve. "Për të ardhur deri këtu, të gjithë kaluan nga segmenti e ri të Pyllit të Sodës, por na u desh të futemi për disa qindra metra në shtegun e dhive të tranzicionit, siç e gjetëm Vlorën në të gjithë infrastrukturën e saj 4 vite e gjysmë më parë", u shpreh Rama. Në

**Kryeministri Rama: Aeroporti i ri do të garantojë çmime të arsyeshme**

**Vlahutin në Vlorë: Duhet të ofroni standardet e BE-së që të keni turistë**

fjalën e tij kryeministri ka premtuar se plehrat do të zhduken nga ky qytet, bashkë me ujërat e zeza, duke siguruar një vijë të pastër bregdetare. Gjithashtu, Rama nuk ka harruar pa përmendur edhe investimin më të madh që pritet të kryhet në këtë qytet, atë të aeroportit të Vlorës. "Aeroporti i

Vlorës do të jetë një investim masiv, pasi ai do të jetë aeroporti i jugut të vendit. Do të garantojë lëvizje nga Vlora drejt Greqisë apo Italisë me çmime edhe më shumë të arsyeshme nga ato që janë sot", u shpreh Rama. Nga qyteti bregdetar gjatë inaugurimit të impiantit të përpunimit të ujërave të

zeza, ambasadorja Romana Vlahutin u shpreh se Bashkimi Europian do të vijojë që të investojë. Ajo u shpreh se Vlora është transformuar në pak vite, ndërsa Shqipëria duhet të arrijë standardet për të vijuar rritjen e numrin e turistëve. "Që turistët të rikthehen duhet të ofroni standarde të BE, sido-



mos kur bëhet fjala për ushqim të sigurt, plazhe të pasura dhe infrastrukturë. Më shumë se 90 mln euro janë dedikuar nga BE për trajtimin e ujërave në disa qytete në Shqipëri. Ne plani-

fikojmë të investojmë mbi 50 mln euro në Vlorë, vetëm 15 janë investuar në këtë impiant. Ata që ndotin duhet që të paguajnë koston, kujdesuni për lumenjtë tuaj", tha Vlahutin.

Opozita pritet të ndërmarrë masa ekstreme në mbrojtje të godinës së Teatrit Kombëtar, pas miratimit të ligjit

**Basha 5 ditë në Uashington, takime në Departamentin e Shtetit**

*PD nënshkroi kontratë të re lobimi me kompaninë "Sonoran Policy Group LCC"*

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, u nis dje drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku do të zhvillojë një seri takimesh zyrtare. Selia blu nuk ka informuar për axhendën e takimeve të Bashës, por burimet i thanë "Ora News" se ai do të qëndrojë në Uashington, deri në datën 12 korrik. Gjatë këtyre ditëve parashikohen edhe takime në Departamentin Amerikan të Shtetit. Nuk dihet nëse kreu i PD-së do të ketë ndonjë takim me ambasadorin e re të emëruar në Tiranë dhe që do të zëvendësojë Donald Lu. Vizita 5-ditore e kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha në Shtetet e Bashkuara vjen në një moment të rëndësishëm politik në Shqipëri, kur opozita ka paralajmëruar një aksion të fortë kundër qeverisë, ndërsa në opionet e saj nuk janë vetëm protesta, por edhe mundësia e bojkotit të institucioneve apo një vendim më ekstrem, siç mund të jetë dëgjia e mandateve. Të enjten e kësaj jave, opozita pati një qëndresë të fortë në Kuvend për ligjin e miratuar nga mazhoranca për ngritjen e godinës së re të Teatrit Kombëtar. Ndërkohë, bëhet e ditur se PD ka parashikuar masa ekstreme në mbrojtje të teatrit, por ende nuk specifikohet se cilat do të jenë këto masa në vijim. Ndërkohë, vetëm pak javë më parë u bë publike kontrata e re e lobimit që PD firmosi me një tjetër kompani amerikane, pas skandalit të publikuar nga revista amerikane "Mother Jones", e cila hidhte dyshime për lidhjen mes PD-së dhe lo-buesve rusë. Kontrata është firmosur më 12 qershor të këtij muaji dhe është kryer me firmën e lobimit "Sonoran Policy Group LCC", një kompani kjo e njohur për kontaktet e saj me njerëz pranë Presidentit të SHBA-ve, Donald Trump. Kontrata do të jetë e vlefshme deri në muajin tetor të këtij viti. Ende nuk dihet se për çfarë e ka nënshkruar një kontratë të tillë PD, pasi interвали nuk përkon me zgjedhjet, ku më të afërtat janë vitin e ardhshëm. Në fakt një kontratë të tillë, Basha do ta përdorë për lobim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku tashmë është bërë e qartë se si funksionon rezervimi i takimeve me personalitetet e larta të SHBA-ve.



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

**JORIDA TABAKU**

"Masat e PD-së do të jenë ekstreme. Sigurisht në mbështetje të artistëve dhe qytetarëve të Tiranës, duke vazhduar që nga protesta deri tek aksioni ligjor, duke vazhduar njëkohësisht edhe me masa drastike në ditët dhe javët në vijim", u shpreh deputetja e PD-së në lidhje me reagimin e PD-së pas miratimit të ligjit për teatrin.

**Kullat tek Teatri, Saliانji: Lidhje mafioze mes kompanisë dhe Edi Ramës**

Opozita vijoi dje me akuzat e saj ndaj mazhorancës në lidhje me prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar. Deputeti Ervin Saliانji akuzoi kompaninë "Fusha" se ka marrë përsipër pastrimin e parave të Edi Ramës me 6 kullat që do të ndërtohen pas shembjes së teatrit. "Ne treguam se si 'Fusha' ndërtoi në të zezë godinën luksoze të kryeministrit për të paktën 5 milionë euro dhe mori prej Edi Ramës rreth 80 milionë euro tendera, shumica pa garë, si dhe një koncesion 125 milionë euro. Sot ne po u bëjmë të ditur shqiptarëve se kompania 'Fusha' është subjekt i ligjit antimafia dhe subjekt që mund të pastrojë paratë e pista të drogës dhe trafikëve. Lidhjet e gjakut janë ato që shpëtojnë gjithçka", u shpreh dj Saliانji. "Petrit Fusha, që deri dje drejtonte Prokurorinë e Tiranës, është vëllai i trafikantit ndërkombëtar të drogës, menaxhon një resort të njohur në periferi të Tiranës dhe mbyll dosjet penale për Erion Veliانjin dhe qeverinë e Edi Ramës", tha Saliانji.

**Ekspertiza e audiopërgjimit të Xhafajt, Vasili: Kryeprokurorja, e kapur nga Rama**

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vailli akuzoi dje kryeprokurorin Arta Marku se nuk ka nisur hetim për audiopërgjimin për vëllain e ministrit Fatmir Xhafaj. "Kryeprokurorja bën shejtan budallanë sa herë që shkelësi i ligjit është kryeministri. Ditën për ditë, kryeministri futi duart për mbylljen e çështjes së audiopërgjimit të vëllait të ministrit të Brendshëm. Kryeministri ndërhyri, imponoi, manipuloi opinionin duke deklaruar se kishte kryer ai ekspertizën, se kishte



marrë edhe rezultatet dhe çdo gjë ishte manipulim sipas tij. Ky mashttrim shumë i rëndë publik i kryeministrit dhe përfshirja e tij në një çështje penale të një rëndësie të jashtëzakonshme janë

faje penale të pakapërcyeshme, ndaj të cilave prokurorja heshti dhe vazhdon të heshtë, duke u bërë edhe ajo pjesë e këtij shpërdorimi kolosal të pushtetit dhe fshesjes së drejtësisë", u shpreh dje përmes një statusi në "Facebook" Vasili. "Nëse kryeprokurorja nuk e bën dhe nuk guxon të procedojë kryeministrin fajtor, vetingu i vërtetë i saj nuk do të jetë ai për pasurinë, por për shpërdorimin e detyrës dhe për mbulimin e fajeve shumë të rënda penale dhe publike të kryeministrit", tha Vasili.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**

**ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2018**

Banka e Shqipërisë fton të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në konkursin e hapur "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2018", i dedikuar për studentët shqiptarë të diplomuar gjatë periudhës 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018, brenda dhe jashtë vendit, për punë shkencore në një nga çështjet e ekonomisë monetare e ndërkombëtar, stabilitetit financiar, çështje të integritetit ekonomik të vendeve të Ballkanit në Evropë, politika monetare dhe politikave makroprudeniale të Bankës së Shqipërisë, politika fiskale dhe roli i tyre në ekonomi, sistemi bankar shqiptar, sjelljet e individëve dhe firmave në Shqipëri, si dhe aspekte të ekonomisë në përgjithësi

Studentët të interesuar duhet të paraqesin në formë elektronike<sup>1</sup> (pdf) në adresën elektronike [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org), dokumentet e mëposhtme:

- një letër ku shprehet interesim i studentit për të konkurruar për Çmimin në fjalë;
- Curriculum Vitae;
- abstraktin dhe një përmbledhje të shkurtër të gjetjeve kryesore;
- emrin e udhëheqësit të temës dhe universitetin/fakultetin përkatës;
- temën e diplomës.

Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve është data **31 tetor 2018**.

Për më shumë informacion mbi rregullat e pranimit, lutemi vizitoni faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org) ose shkruani në adresën e emailit [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org).

<sup>1</sup> Mesazhi elektronik drejtuar Bankës së Shqipërisë në adresën [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org) duhet t'i referohet "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2018".



## KRIMI KIBERNETIK

### INTERVISTA

Ina Allkanjari

"Në vit kemi vetëm 4-5 persona të dënuar me vendim të formës së prerë"

# Krimi kibernetik, flet eksperti Semanaj: Shqipëria, e rrezikuar!

"Vendi ynë, me teknologji të limituar për të siguruar mbrojtjen e qytetarëve"

**K**rimi kibernetik është çdo veprim kriminel që përfshin një kompjuter, një pajisje të rrjetëzuar ose një rrjet. Ndërsa shumica e virusëve kibernetike janë kryer në mënyrë që të gjenerojnë fitim për kriminelët, disa krime kibernetike janë kryer kundër kompjuterave ose pajisjeve direkt për të dëmtuar ose çaktivizuar ato, ndërsa të tjerët përdorin kompjuterë ose rrjete për të përhapur informacion të paligjshëm, imazhe apo materiale të tjera. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", eksperti i krimit kibernetik në Shqipëri, Besmir Semanaj, na shpjegon rreziqet kryesore që vijnë nga ky fenomen kriminal gjithnjë e në rritje. Sipas specialistit Semanaj, të gjithë jemi të ekspozuar, aq më tepër në vendin tonë, ku kapacitetet për t'u mbrojtur janë të limituara.

**Në ditët e sotme një fenomen gjithmonë dhe më shqetësues është krimi kibernetik. Cili është qëllimi kryesor i këtyre sulmeve?**

Qëllimi dhe metodologjia e piraterisë ka ndryshuar me kalimin e viteve. Nëse vellezërit Alvi piratonin për t'i treguar botës aftësitë e tyre dhe të bëheshin të famshëm, në ditët e sotme 'hacker'-at (piratët informatikë) mudoheq që të futen në sistemet tuaja dhe të qëndrojnë sa më shumë të jetë e mundur, pa u vënë re. Qëllimi i tyre është të marrin të dhënat që dëshirojnë ose të përdorin kompjuterët tuaj për qëllimet e tyre. Këto mund të jenë informacione sekrete si të dhënat bankare, kartës së identitetit, materiale komprometuese deri tek më banalja, posedimi i një fotoje. Për shembull, posedimi i kartës së identitetit ose kartës bankare nuk konsiston thjesht në përdorimin e tyre dhe harxhimin monetar, por këto mund të përdoren edhe për kryerjen e transakcioneve të paligjshme. Me një denoncim të mundshëm do të jetë shumë e vështirë të vërtetohet që përdoruesi nuk kenë qenë ju, por një keqbërës që ka "hackuar" kompjuterin tuaj personal. Përveçse një viktimitë me pasojë monetare, jeni edhe një i dyshuar me

precedent penal.

**A ka Shqipëria kapacitete të duhura për ta luftuar krimin kibernetik?**

Shqipëria në momentet që flasim ka një deficiençë në teknologji dhe burime njerëzore për të luftuar krimin kibernetik dhe për të siguruar mbrojtjen e qytetarëve. Kjo lidhet me funksionimin e organizmave shtetërore që merren me këtë pjesë dhe kanë si objektivi mbrojtjen dhe luftën ndaj këtij krimi. Këtu bëjnë përjashtim kompanitë e mëdha dhe serioze, të cilat përpiqen me aq mundësi sa kanë dhe në respektim të ligjit aktual të mbrojnë të dhënat e tyre sensitive dhe të klientëve. Mbrojtja ndaj krimin kibernetik kërkon një impenjim më të lartë nga të gjitha organizmat si shtetërorë dhe private, duke përfunduar deri tek përdoruesi fundor që kanë qasja në një rrjet ose në internet. Vitet e fundit shikojmë një ndërgjegjësim të të gjitha palëve në këtë luftë ndaj këtij krimi të ri, por po aq të rrezikshëm sa edhe vetë terrorizmi. Për të shtuar sigurinë dhe rritur luftën janë disa pika që duhet të kemi parasysh.

**Cilat janë këto pika?**

Pika më e thjeshtë, por nga më të rëndësishmet është vetëdija e rrezikut dhe bërja të ditur jo vetëm organizmave shtetërorë dhe kompanive, por e të gjithë popullatës. Shqipëria ka nevojë për një projekt zhvillimi dhe trajnimi ku çdo qytetar të kuptojë rrezikun dhe të jetë në gjendje të krijojë një mbrojtje minimale. Shtimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknologjisë në organizmat që merren me këtë luftë. Sot kemi institucione që me kapacitetet që kanë po bëjnë një punë të mirë, por janë të kushtëzuar në punën e tyre nga sasia e madhe e informacionit dhe pamundësia e përpunimit të këtij informacioni. Dalje më të shpeshta publike dhe mediatake ku popullata të instruktoret se ku duhet të drejtohet në raste kur dyshon për një krim kibernetik. Fuqizimi dhe shtrëngimi i ligjeve në fuqi, në



Eksperti i krimit kibernetik, Besmir Semanaj

mënyre që të shtohen dënimet ndaj personave që kryejnë krime kibernetike. Rritja e bashkëpunimit me agjencitë partnere, të cilat kanë kapacitete shumë më të larta se Shqipëria.

**Çfarë thonë raportet ndërkombëtare për Shqipërinë?**

Nëse lexojmë raportet ndërkombëtare, ndëshkueshmëria në Shqipëri për rastet e krimit kibernetik është shumë e vogël, kemi vetëm deri në 5 persona të dënuar me vendim të formës së prerë në vit. Besoj që pas hapjes së negociatave me BE, do kemi zhvillim në këtë fushë, duke qenë se është dhe një nga kapitujt, të cilët Shqipëria duhet të plotësojë.

**Ju thonë që nuk kemi statistika në Shqipëri. Mund të kemi statistika ndërkombëtare, në mënyrë që të bëhet më i kuptueshëm rreziku?**

Raportet ndërkombëtare

na japin shifra të frikshme, të cilat duhet të na bëjnë të jemi të ndërgjegjshëm për rrezikun dhe të marrim masa duke filluar nga pajisjet personale dhe duke përfunduar te politikat shtetërore.

Duke u bazuar në statistikat e vitit 2017, kemi një

## NEGOCIATAT

Nëse lexojmë raportet ndërkombëtare, ndëshkueshmëria në Shqipëri për rastet e krimit kibernetik është shumë e vogël, kemi vetëm deri në 5 persona të dënuar me vendim të formës së prerë në vit. Besoj që pas hapjes së negociatave me BE, do kemi zhvillim në këtë fushë, duke qenë se është dhe një nga kapitujt, të cilët Shqipëria duhet të plotësojë.

tocurrency.

**Një nga rastet që mori shumë vëmendje ishte ai i një hakeri shqiptar nga Fieri, i cili ishte i lidhur me një grup amerikan. A po flasim për një rast të izoluar, apo ka edhe persona të tjerë në Shqipëri që përbëjnë rrezik të tillë?**

Sipas hetuesve amerikanë, kjo organizatë kishte grabitur në total të dhëna nga 4.3 milionë llogari bankare. Në

ansjë statistikë mbi zbulueshmërinë e personave që merren me krimin kibernetik. Institucionet tona duhet të jenë pro-aktive në këtë luftë dhe duhet të rrisin zbulueshmërinë.

**Si mund të mbrohet secili nga ne nga ky fenomen, duke qenë se jemi gjithnjë të ekspozuar?**

Do doja të lista disa pika, të cilat secili nga përdoruesit e internetit duhet t'i ketë parasysh.

Instaloni një 'Firewall', që të parandalojë aksesin nga jashtë në kompjuterët tanë. Pra, me sistemin tonë mund të lidhen nëpërmjet internetit vetëm ata të cilët i lejojmë. Instaloni një 'software antivirus'. Të gjithë kompjuterët tanë duhet të kenë versionin më të fundit të një programi antivirus. Siguroni lidhjen tuaj, pra kur të hyni në një llogari sensitive, vendi më i mirë është shtëpia ose zyra tuaj. Nëse do të përdorni Wi-Fi, rrisni sigurinë me një rrjet privat virtual. Kjo krijon një link të sigurt, të koduar me serverin e një pale të tretë dhe ju mund të aksesoni sitet tuaja nëpërmjet këtij linku. Ky është një nivel më shumë mbrojtjeje dhe hacker-at nuk do kenë mundësi ta kalojnë. Ndryshoni fjalëkalimin për t'u mbrojtur nga thyerja ose vjedhja. Gjithashtu, tregohuni vigjilent pasi mënyra më e mirë për të ruajtur llogarinë tuaj bankare ose ndonjë llogari tjetër është të tregoni kujdes. Nëse do të kapni problemet e vogla herët, do të kenë mundësi të parandalojnë 'hacker'-at të mos shkaktojnë probleme më të mëdha.

**Duke parë zhvillimi e teknologjisë dhe njëherësh rrezikun që vjen prej saj, çfarë do u këshillonit të rinjve?**

Kam një thirrje për të gjithë studentët dhe ekspertët e rinj në ICT, që të investojnë në këtë fushë, sepse do të fusha e së ardhmes. Tregu i punës të sigurisë në internet pritet të arrijë 3.5 milionë deri në vitin 2021, krahasuar me rreth 1 milion në vitin 2016.

## SIGURIA

Të gjithë kompjuterët tanë duhet të kenë versionin më të fundit të një programi antivirus. Siguroni lidhjen tuaj, pra kur të hyni në një llogari sensitive, vendi më i mirë është shtëpia ose zyra tuaj. Nëse do të përdorni Wi-Fi, rrisni sigurinë me një rrjet privat virtual.

kosto monetare, e cila përlllogarit në \$400 bilionë nga ana tjetër kemi mbi 500 milionë kompjutera të cilët përdoren për "minning" në rrjet për të gjeneruar të ardhura në cryp-

kohën e internetit dhe me zhvillimin teknologjik në Shqipëri nuk mund të flasim për rast të izoluar. Ky është rasti i zbuluar nga partnerët tanë. Ne si shtet nuk kemi

Panik në mes të plazhit, pushues të shumtë vënë në pikëpyetje sigurinë

DHERMI

Një përplasja me armë zjarri në plazhin e Dhërmit ka vënë në panik pushues të huaj e shqiptarë, ku protagonist i saj është bërë një 23-vjeçar nga Tirana. Ngjarja e rëndë ndodhi mbrëmjen e së shtunës, në një nga lokalet e natës në këtë zonë, ku Emiljano Nina ka nxjerrë armën e zjarrit tip pistoletë duke qëlluar 4 herë në ajër. Shkak është bërë një konflikt i hershëm i të riut me një tjetër person që ndodhej në disko "Havana". Uniformat blu bënë me dije se kanë arrestuar autorin dhe po vijojnë hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Por përplasja me armë ka shkaktuar panik te turistët, të cilët kanë zgjedhur Dhërmin për të pushuar, duke vënë në pikëpyetje edhe sigurinë në zonat turistike, pavarësisht masave të marra nga policia për mbarevajtjen e sezonit. Pushues të shumtë, vendës dhe të huaj, të mbledhur në lokalin me emrin "Havana", të kapur në panik dhe për t'u shpëtuar plumbave janë larguar të tmerruar e me shpejtësi, duke shkelur mbi njëri-tjetrin. Dëshmitarë okularë kanë treguar në forma të ndryshme, përmes postimeve në rrjetet sociale apo dëshmi për gazetaret ngjarjen e rëndë. Ata janë shprehur se njerëzit veç plumbave që mund të kishin marrë nga të shtënat e armës, u lënduan edhe në tentativa e sipër për të dalë nga klubi i natës. Zyrtarisht policia sqaron se nga kjo ngjarje nuk ka pasur asnjë të plagosur apo dëmtuar. Sipas uniformave blu, 23-vjeçari Nina ka qëlluar me armë zjarri 4 në ajër, duke terrorizuar të pranishmit në disko. "Nga veprimet e para të kryera ka rezultuar se në një lokal shtetasi Emiljano Nina është konfliktuar për motive të dobëta (të hershme) me një tjetër shtetas

# Përplasja me armë në disko në Dhërmi, kush është Emiljano Nina

## Qëlloi katër herë në ajër, policia: Nuk ka njerëz të lënduar



### E SHKUARA E EMILJANO NINËS

Emiljano Nina nuk është emër i panjohur për policinë. 23-vjeçari që njihet ndryshe edhe me emrin Emiljano Tasho, është shoqëruar edhe më herët nga uniformat blu. Në vitin 2015, ai u shpall në kërkim nga policia për një ngjarje të rëndë kriminale të ndodhur në Tiranë. Bëhet fjalë për vrasjen e 30-vjeçarit Enton Nikaj, që ndodhi në nëntor në parkingun e një restoranti në Linzë, ku mbeti i plagosur edhe pronari i biznesit. Emiljano Nina, në atë kohë 20 vjeç, u shpall në kërkim si person i dyshuar për përfshirje në vrasje. Pasi u shoqërua nga policia për këtë ngjarje, u la i lirë sepse u provua të kishte gisht në krim.

e për pasojë konflikti ka agravuar më tej, ku shtetasi Emiljano Nina ka shtënë 4 herë me armë zjarri në ajër. Nga të shtënat nuk ka persona të lënduar. Në përfundim të veprimeve hetimore është kryer arrestimi në flagrancë i autorit, shtetasi

Emiljano Nina, 23 vjeç, banues në Tiranë. Po në kuadër të veprimeve të kryera është bërë e mundur dhe gjetja e sekuestrimit armës së zjarrit pistoletë me dy fishekë. Materialet hetimore do t'i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për

### ARRESTIMI

"Nga veprimet e para të kryera ka rezultuar se në një lokal, shtetasi Emiljano Nina është konfliktuar për motive të dobëta (të hershme) me një tjetër shtetas e për pasojë konflikti ka agravuar më tej, ku shtetasi Emiljano Nina ka shtënë 4 herë me armë zjarri në ajër. Nga të shtënat nuk ka persona të lënduar. Në përfundim të veprimeve hetimore është kryer arrestimi në flagrancë i autorit, shtetasi Emiljano Nina, 23 vjeç, banues në Tiranë.



## Vdekja e dy të rinjve tek ish-uzina, kreu i Bashkisë Kurbini: Të ndërhyjë qeveria

**KURBIN-** Pas shembjes së një godine në ish-uzinën e Laçit ditën e shtunës, ku gjeti vdekjen 27-vjeçari Drilon Lamaj, mësohet se numri i viktimave ka shkuar në dy. Ditën e djeshme ndërroi jetë në spitalin e traumës edhe 22-vjeçari Dëshamir Jahja. Dy të rinjtë ishin duke mbledhur hekura për skrap në ish-uzinën e superfosfatit, por një pjesë e betonit u shkëput duke i zënë poshtë. Banorët e zonës u erdhën në ndihmë dy djemve, duke i nxjerrë nga rrënojat dhe më pas u dërguan në spitalin e Traumës në Tiranë, por nuk mundën t'u mbijetojnë plagëve të marra. Pas vdekjes së dy të rinjve, kreu i Bashkisë së Kurbinit kërkon që qeveria të ndërhyjë menjëherë. Artur Bardhi i ka bërë thirrje qeverisë për ndërhyrje, pasi sipas tij, ish-uzina e Laçit prej kohësh përbën një rrezik për ata që nxjerrin skrap dhe përmban helme. "I bëj thirrje qeverisë të ndërhyjë menjëherë. Ish-uzina e Laçit përbën një rrezik të vazhdueshëm për ata që kërkojnë të nxjerrin skrap. Ish-uzina është një zonë e kontaminuar me helme dhe e rrezikshme", - ka thënë kreu i Bashkisë së Kurbinit. Uzina e superfosfatit në Laç është ndërtuar në vitin 1965, por prej më tepër se dy dekadash është jashtë funksionit. Ndonëse kjo godinë ruhet me roje, të cilët paguhen rregullisht, në të mund të hyjë kushdo. Ngjarje të tilla me pasojë humbjen e jetës së njerëzve që tentojnë të mbledhin skrap për të jetuar, nuk janë të pakta në Shqipëri.

**unicef** for every child UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF) Albania Country office

**REQUEST FOR PROPOSAL FOR SERVICES**

**Subject: Develop and implement a model for the digitalization of birth - related records and their online transfer from maternities to Primary Health Care facilities.**

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive proposals from interested organizations/companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Please consult UNICEF Albania website ([www.unicef.org/albania](http://www.unicef.org/albania)) or UN Albania website (<http://www.un.org/al/employment-and-procurement>) to download the detailed RFPS document and other related requirements.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The offers must be delivered within the set deadline, in a sealed envelope which must be clearly marked: "LRPS-2018-9140968 - Develop and implement a model for the digitalization of birth - related records and their online transfer from maternities to Primary Health Care facilities." to the address below:

**United Nations Children's Fund (UNICEF)**  
Rr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania  
Tel. +355 44548400; Website: [www.unicef.org/albania](http://www.unicef.org/albania)

**Relevant Dates:** All interested companies must submit their application, not later than **16 July 2018, 12:00 hrs.**

**Suedi Sverige** **INSTAT** Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave

**INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA**

2061	Suzana	Skender	Miraka (Ibrahimi)	19.07.2018	11:30
2062	Suzana	Ylison	Tabaku	19.07.2018	11:30
2063	Syri	Fecor	Mimami	19.07.2018	11:30
2064	Shaban	Leonard	Brahimaj	19.07.2018	11:30
2065	Shaha	Xheladin	Dauti	19.07.2018	11:30
2066	Shefik	Riza	Rama	19.07.2018	11:30
2067	Shega	Pëllumb	Zeneli	19.07.2018	11:30
2068	Sherif	Zyhdit	Gjoshi	19.07.2018	11:30
2069	Shero	Fadil	Braho	19.07.2018	11:30
2070	Shkëlzen	Dashnor	Pajo	19.07.2018	11:30
2071	Shkurte	Fatmir	Bushgjokaj	19.07.2018	11:30
2072	Shkurte	Shpetim	Peka	19.07.2018	11:30
2073	Shkuptime	Banush	Derrasa	19.07.2018	11:30
2074	Shkuptime	Alush	Tasha	19.07.2018	11:30
2075	Shpresa	Abedin	Guri	19.07.2018	11:30
2076	Shpresa	Ibsh	Llane	19.07.2018	11:30
2077	Shqiponja	Dylber	Hoxha	19.07.2018	11:30
2078	Shpeta	Krenar	Bushaj (Grek)	19.07.2018	11:30
2079	Taulant	Astrit	Gropa	19.07.2018	11:30
2080	Taulant	Shefki	Mema	19.07.2018	11:30
2081	Taulant	Riza	Menalla	19.07.2018	11:30
2082	Tea	Petro	Qose (Ferattllari)	19.07.2018	11:30
2083	Tellona	Nuri	Lesqaj	19.07.2018	11:30
2084	Tisiana	Leart	Memaj	19.07.2018	11:30
2085	Tonalda	Petraq	Tona (Kalla)	19.07.2018	11:30
2086	Thimaj	Pandeli	Karapanxho	19.07.2018	11:30
2087	Thodhorli	Irakli	Foto	19.07.2018	11:30
2088	Thoma	Thoma	Pietri	19.07.2018	11:30
2089	Theda	Artan	Braculla	19.07.2018	11:30
2090	Ulvia	Zenel	Tashiri	19.07.2018	11:30
2091	Vallbona	Ewër	Beqa	19.07.2018	11:30
2092	Valdete	Agim	Fiku	19.07.2018	11:30
2093	Valdete	Skënder	Vojdulla	19.07.2018	11:30
2094	Valentin	Skënder	Dervishi	19.07.2018	11:30
2095	Valentina	Foti	Dapellari	19.07.2018	11:30
2096	Valentina	Ferdinand	Dhamo	19.07.2018	11:30
2097	Valentina	Xhavit	Islamaj	19.07.2018	11:30
2098	Valentina	Bilbil	Shehu	19.07.2018	11:30
2099	Valmir	Clirim	Grek	1	

Ngërçi rajonal, presidenti kosovar flet për revistën holandeze

# Thaçi: Duhet një marrëveshje përfundimtare me Serbinë

Vulin: Mali i Zi po "ngre zërin" për pavarësinë e Kosovës

Revista më e vjetër diplomatike në Holandë "Diplomat", ballinën e numrit të saj më të ri ia ka kushtuar Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Kjo revistë diplomatike ka shkruar për mesazhet diplomatike të presidentit Thaçi, të dhëna në institutin holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare "Clingendael". "Pajja dhe drejtësia janë dy çështje themelore për çdo shoqëri, veçanërisht për ato në tranzicion", citohet të ketë thënë Thaçi, shkruan "Diplomat". Revista e parë diplomatike holandeze ka shkruar se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka prodhuar një marrëveshje historike në Bruksel, saktësisht pesë vjet më parë. "Ne jemi krenarë me luftën tonë për liri dhe nuk kemi asgjë për të fshehur apo për t'u frikësuar nga e vërteta. Askush asnjëherë nuk u përpoq të ikte apo të fshihej nga drejtësia, krahasuar me shtetet e tjera në rajon", citohet të ketë thënë Thaçi. Duke folur për shtetndërtimin në Kosovë, presidenti Thaçi ka theksuar se vetëm dhjetë vjet më parë, Kosova shpalli republikën më të re në Evropë dhe tani mund t'i shikojmë me krenari arritjet gjatë dekadës së kaluar. "Kosova është një rëfëmijë suksesi, por kemi ende sfida të shumta, ashtu siç kanë edhe të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor", ka thënë ai. Sipas revistës holandeze "Diplomat", presidenti kosovar gjatë qëndrimit në Holandë ka numëruar tri sfida më të rëndësishme, ku një prej tyre është edhe përmbyllja e dialogut me Serbinë. "Si Kosova, ashtu edhe Serbia duan të jenë



Hashim Thaçi

## ALEKSANDAR VULIN

"Kosova nuk është shtet, por territor përkohësisht në administrim të OKB-së e në përputhje me Rezolutën 1244. Ministri malazez i Mbrojtjes po e përfaqëson pavarësinë e Kosovës më shumë se Shqipëria. Do të kishim respektuar më tepër dërgimin e ushtarëve malazezë, sikur vetëm një ushtar ta kishin dërguar për të mbrojtur manastiret e jo në shtab si mbrojtje të pavarësisë së Kosovës", ka thënë Vulin.

pjesë e Bashkimit Evropian dhe të dyja shtetet e dimë se duhet ta njohim njëri-tjetrin. BE-ja nuk do të na pranojë me probleme. Ne kemi nevojë për një marrëveshje ligjërish të

detyrueshme. E di se do të jetë jashtëzakonisht e vështirë për të dyja palët dhe mbi të gjitha për Kosovën. Por, jam i bindur se dialogu dhe marrëveshja janë e vetmja rrugë përpara", ka

## HASHIM THAÇI

"Ne jemi krenarë me luftën tonë për liri dhe nuk kemi asgjë për të fshehur apo për t'u frikësuar nga e vërteta. Askush asnjëherë nuk u përpoq të ikte apo të fshihej nga drejtësia, krahasuar me shtetet e tjera në rajon", citohet të ketë thënë Thaçi.

thënë Thaçi, shkruan "Diplomat". Kjo revistë shkruan se sfida tjetër për Kosovën është ekonomike. "Kosova po vazhdon të shënojë rritje ekonomike, por ka nevojë për të krijuar më shumë vende pune. Ne duhet të përqendrohemi në ekonominë e re dhe të mundësitë e reja. Nuk është e lehtë dhe ende duhet të bëjmë më shumë reforma strukturore", citohet të ketë thënë Thaçi. Ndërkaq, sfida e tretë, presidenti Thaçi ka thënë se ka të bëjë me integrimin e Kosovës në NATO dhe BE, ku sipas tij, Kosova po punon në përmirësimin e kritereve demokratike në politikë, ekonomi dhe legjislacion. Revista më e vjetër diplomatike në Holandë ka shkruar edhe

për librin biografik për Hashim Thaçin "New State, Modern Statesman", të promovuar para shumë përfaqësuesve të shtetit holandez, diplomatëve, ambasadorëve, gazetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në Institutin holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare "Clingendael". Ndërkaq, ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandar Vulin ka kundërshtuar deklaratën e ministrit të Mbrojtjes të Malit të Zi, Predrag Boshkoviq se Kosova është shtet, por territor përkohësisht në administrim të OKB-së e në përputhje me Rezolutën 1244", ka thënë ai duke reaguar pasi Mali i Zi ka dërguar dy oficerë në misionin e KFOR-it. "Kur Mali i Zi dërgon oficerë në mision në territorin e Serbisë, rregulli i parë është që të pyetemi edhe ne", ka thënë Vulin. "Ministri malazez i Mbrojtjes po e përfaqëson pavarësinë e Kosovës më shumë se Shqipëria. Do ta kishim respektuar më shumë dërgimin e ushtarëve malazezë, sikur vetëm një ushtar ta kishin dërguar për të mbrojtur manastiret e jo në shtab si mbrojtje të pavarësisë së Kosovës", ka thënë Vulin.

## SHKURT

**Zaev: Marrëveshja me Greqinë për emrin, përfundimtare të gjithanshme**

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev shprehet se marrëveshja e fqinjësisë së mirë me Bullgarinë dhe ajo për emrin me Greqinë do të kontribuojnë për bashkëpunim më intensiv të Maqedonisë me vendet e rajonit. Ai në fjalimin e tij në seancën plenare të kryeministrave të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore me Kinën tha se Maqedonia është vend i vogël, i cili është i përkushtuar konceptit të lidhjeve. Kryeministri tha se me përpjekje të përbashkëta, vendet nga rajoni mund të bëjnë destinacion tërheqës për kompanitë kinëze. Në samitin njëditor që po zhvillohet në Sofje, Zaev është i shoqëruar nga zëvendëskryeministri i Ekonomisë, Kocjo Angushev dhe nga ministri i Transportit, Goran Sugarevski.

**Rëndohet bilanci i viktimitave nga përmbytjet në Japoni**

Bëhet gjithmonë me drama matike situata nga përmbytjet që ka përfshirë Japoninë, me numrin e viktimitave që vazhdojnë të rriten dhe shumë të humbur deri tani. Për momentin, numri i të vdekurve ka shkuar në 51, ndërsa të zhdukur regjistrohet me 48. Prefektura e Hiroshimës në përdim të arkipeلاجut, më e goditura nga përmbytjet ka dhe numrin më të madh të viktimitave, 22 të vdekur dhe 23 të zhdukur. Aksidente me pasojë vdekjen janë regjistruar edhe në prefekturat e Ehime, Okayama, Hyogo, Kyoto, Shiga dhe Fukushima. Shirat e furishëm që bien ç prej të enjtes së kaluar kanë vështirësuar operacionet e shpëtimit dhe shtojnë rrezikun e rrëqitjeve të tokës në zonat e Kansai dhe në pjesën e sipërme të Kyushu.

## Nisin shirat, dalja zgjat disa ditë, 11 orë për çdo person

### Tailandë, nis operacioni i 'Navy Seals' për shpëtimin e 12 djemve nga shpella Tham Luang

Ditën e djeshme nisi operacioni i shpëtimit në Tailandë i 'Navy Seals' për të nxjerrë jashtë shpellës 12 djemtë e bllokuar prej dy javësh së bashku me trajnerin e tyre. "Sot është D-day dhe djemtë janë gati për të përballuar çdo sfidë", ka thënë për gazetaret shefi i operacionit Narongsak Osatanakor. Në zonë kanë filluar shirat dhe kjo ka shtyrë skuadrat e shpëtimit, që do ndihmojnë në nxjerrjen jashtë të futbollistëve, të përshpejtojnë operacionin. Djali i parë që do të nisë udhëtimin drejt lirisë

është një 14-vjeçar, i pari nga djemtë e zgjedhur nga forcat e ushtrisë dhe të forcave të shpëtimit. Është nga ata më të fuqishmit dhe prandaj është zgjedhur pikërisht i pari për këtë dalje të mundimshme. Në zonë kanë filluar shirat. Në zonën rreth shpellës Tham Luang ka filluar shiu, edhe pse jo me vrullin dhe intensitetin e madh që e karakterizon këtë zonë, duke rrezikuar që shpella të mbulohet sërish me ujë. Duke njoftuar për lirimin të shpejtë të tyre, përgjegjësit e operacionit thanë që është e

nevojshme ta bëjnë tani për shkak të përkeqësimit të situatës nga shirat që priten të vijnë. Dalja nga shpella do të bëhet në më të shumtën e rrugës në këmbë. "Pjesa më e madhe e rrugës për të dalë nga shpella do të bëhet në këmbë dhe niveli i ujit tani është më i ulët i ditëve të fundit", sqaron guvernatori Narongsak Osatanakor, përgjegjës i operacionit, i cili nuk ka specifikuar se për sa metra fëmijët do të zhyten në ujë. Operacioni i shpëtimit do të zgjasë disa ditë dhe kjo varet edhe nga moti, thonë përgjegjësit e operacionit.

acionit. Djali i parë që do të dalë nga shpella pritet të jetë në 'liri' jo më parë se ora 16 me orën tonë e ditës së sotme. Do të jenë rreth 18 zhytës profesionistë në ndihmë të djemve. Çdo fëmijë do të ketë dy zhytës në dispozicion, të cilët do të jenë të lidhur mbas një kavoje. Mes zhytësve 13 janë të huaj dhe 5 tajlandezë. Nxjerrja jashtë e djemve ka nisur në orën 10 të së dielës (ora lokale) ora 5 e mëngjesit me orën tonë. Operacioni do të zgjasë 11 orë për çdo fëmijë. Për operacionin janë vënë në dijeni të gjithë familjarët e djemve dhe shpëtimin do të jetë tek e tek. Gazetarët janë spostuar rreth 2 km nga hyrja e shpellës rreth orës 4 të mëngjesit me orën tonë.

## AKSIDENT TRAGJIK NË KROACI, HUMB JETËN BOKSIERI SHQIPTAR



**FOTOLAJM**

Një aksident i rëndë ka ndodhur në Tsino të Kroacisë ditën e djeshme, ku ka humbur jetën boksieri shqiptar nga Kroacia, Valentin Kajtazi, 27 vjeç. Ai ishte duke udhëtuar me motorin e tij kur është përplasur nga një makinë dhe për pasojë ka ndërruar jetë, shkruajnë mediat kroate. Klubi ku 27-vjeçari u trajnuar për shumë vite, ekipi kroat i Sibenikut, është tronditur nga ky lajm i hidhur. "Çfarë të themi, kur në këtë mëngjes morëm lajmin e trishtuar, të gjithë në klub jemi në gjendje shoku. Valentinin ishte shembull, ai ishte fillastar, por në sajë të këmbënguljes së tij u bë një konkurrent dhe luftoi më së miri. Ky lajm na ka goditur, tha Josko Sunara, trajner i Sibenikut, KBK Petar Kresimir.




## SIMPTOMAT KRYESORE TË SËMUNDJES



Njihuni me tri metodat kryesore që kurojnë dhimbjet e mesit

## KESHILLA



Si të ulni nivelin e kolesterolit me fara luledielli

# Ylli Merja:

◆ Mjeku popullor:  
Rekomandohet për të sëmurët me gastrit, ulçer apo diabet



## Pse duhet ta përdorni susamin gjatë verës

"Forconi organizmin me vajin e kësaj bime"

• 5 këshilla për një zemër të shëndetshme e të fortë. Luftoni hipertensionin me lëkurën e mollës

**Mjeku popullor: Rekomandohet për të sëmurët me gastrit, ulçer apo diabet**

# Ylli Merja:

## Pse duhet ta përdorni susamin gjatë verës

*"Forconi organizmin me vajin e kësaj bime"*



Mjeku popullor, Ylli Merja

Voltiza Duro

**F**arat e susamit janë për dorur që në lashtësi, afër shtyt 1500 vite para erës sonë, madje në Kinë janë konsumuar 3000 vjet para erës sonë. Ushtarët grekë dhe romakë e përdornin si ushqim përpara luftërave ose marshimeve të gjata, pasi u jepte shumë energji. Gjithashtu, susami është një ndër bimët e para, vaji i së cilës është përdorur. Farat dhe vaji i susamit kanë cilësi të pazëvendësueshme. Kjo bimë është e këshillueshme të përdoret në ushqimin e fëmijëve, pasi i ndihmon në rritjen normale. Por farat e susamit mund të përdoren kudo, janë të vogla, nuk janë të bezdisshme në shije apo aromë dhe për më tepër edhe nëse fëmija nuk i pëlqen, mund të "fshihen" lehtë në ushqime të ndryshme. Mund të përdoren në ushqime të ngrohta e të ftohta, mund të futen në kos, gjellë apo lëngje frutash.

**Vlerat e susamit**

Farat dhe vaji i susamit janë një burim mineralësh dhe vitaminash, pasi përmbajnë fosfor, kalcium, acid yndyror linoleik, acid yndyror linolenik, vitaminat B, E, T dhe D, istamina si dhe substanca anti-inflamatore e qetësuese. Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme për organizmin, sidomos në periudhën e verës, pasi ndihmojnë në mbrojtjen ndaj rrezëve UVA dhe UVB të diellit. Susami ndikon në rigjenerimin e qelizave të lëkurës, e ushqen atë dhe largon qelizat e dëmtuara nga dielli. Vaji i susamit mund të përdoret si vaj plazhi, pasi ka efekt mbrojtës ndaj diel-

lit, në të njëjtën kohë ndikon në mosformimin e njollave kafe në lëkurë dhe u jep një ngjyrë të njëltrajtshme që qëndron gjatë. Mund të përdoret si vaj bazë për rreth 90 lloje vajrash të tjera për hollimin e tyre në vaj susami. Nëse përdoret si maskë për flokët, u jep atyre shkëlqim, butësi dhe fortësi.

**Vaji i susamit**

Vaji i susamit forcon organizmin, ju ndihmon të ndiheni më të fuqishëm, sidomos nëse keni tension të ulët dhe dobësi trupore. Vaji dhe farat e susamit të shtypura duhen konsumuar para ushqimit, në këtë mënyrë ato veshin mukozën e brendshme të stomakut dhe forcojnë sistemin nervor të tij. Këshillohet të përdoret në rast se vuani nga gastriti, djegia e stomakut, apo ulçera. Gjithashtu, ky vaj ndalon të vjellat dhe

toksinat në gojë dhe komplet aparatit tretës, kështu mund të përdoret edhe kundër erës së keqe në gojë. Mund ta përzieni me vaj kokosi për t'i dhënë aromë më të këndshme. Ndërkaq, vaji i susamit ushqen lëkurën, e zbut dhe hidranton, në të njëjtën kohë parandalon rrudhat e ndihmon në rigjenerimin

në rigjenerimin e plotë të saj. Vaji i susamit ushqen edhe lëkurën e kokës dhe ndalon rënien e flokëve, kështu që rekomandohet të hidhet në shampo sidomos nga personat që vuajnë nga psoriasis ose dermatiti. Edhe personat që vuajnë nga diabeti mund të konsumojnë këtë

frymëmarrjes. Ndërkohë, sesamoli dhe sesamina që ndodhen tek vaji ndalojnë vdekjen e mitokondrive (magazininë e energjisë së qelizave të njeriut) në qelizat e shëndetshme tek pacientet me kancer. Kështu parandalon kancerin.

Vaji i susamit përmban antioksidantë, antiinflamatorë, të cilët ndikojnë në uljen e inflamacioneve të kockave dhe dhimbjeve që shkakton artriti reumatoid. Përmban rreth 80 për qind acide yndyrore shumë të shëndetshme për organizmin si acid linoleik dhe linolenik. Vlen të theksohet se ky vaj ka në përbërjen e tij edhe vitaminën E dhe B komplekse si dhe proteina dhe fibra, që ndihmojnë në jashtëqitje.

**Përdorimi**

Farat e susamit mund të konsumohen çdo mëngjes një lugë gjelle në një gotë kos, mund të shtohen edhe fara chia dhe pak kanellë. Ky është një mëngjes dietik dhe shumë ushqyes. Nëse nuk ju pëlqen aroma e vajit apo farave të susamit, mund të konsumoni hallve e cila është farë susami e shtypur dhe kryen të njëjtin funksion si fara dhe vaji i susamit. Konsumoni dy lugë gjelle në ditë e hallvë për të larguar djegiet, dhimbjet e stomakut apo erën e keqe të gojës. Vaji i susamit përdoret kudo, në gjellë në kos apo edhe siç është. Konsumohet 2 herë në ditë nga një lugë kafe para ushqimit, mëngjes dhe darkë. Për individët që kanë probleme me kockat është mirë që vaji i susamit apo farat të përdoren për rreth 45 ditë deri në dy muaj. Ndërsa për ata që vuajnë nga diabeti mund të konsumohet çdo ditë vetëm një herë në ditë. Dhe individët që kanë probleme me stomakun mund ta përdorin vetëm 45 ditë.



rregullon pH e stomakut, prandaj largon djegien e tij si dhe detoksifikon organizmin dhe eliminon

e djegieve. Këshillohet të përdoret pas plazhit, i përzier me vaj kokosi në djegiet e lëkurës nga dielli si dhe

vaj, pasi susami ul sheqerin në gjak. Në eksperimente tek minjtë është vërtetuar që ndihmon në rritjen e sistemit imunitar dhe jep efekte pozitive akoma të pazbuluara tek skleroza multiple. Gjithashtu përmban lipide që ndalojnë arteriosklerozën dhe ushqejnë kockën. Disa veta të tjera të mrekullueshme të vajt të susamit janë: ndihmon në zvogëlimin e dhimbjeve të shaktuara nga artriti reumatoid, ndihmon në uljen e tensionit të lartë, përdoret kundër kapsllëkut, parandalon astmën pasi përmban magnezium dhe sëmundje të tjera të aparatit të



**D**himbja e mesit në pjesën e poshtme përshkruhet si një dhimbje e menjëherëshme, e fortë dhe persistente ose si një dhimbje e topitur, që ndihet në pjesën e poshtme të mesit. Ajo është e zakonshme dhe prek pjesën më të madhe të njerëzve gjatë jetës së tyre. Në shumicën e rasteve fillon krejt papritur e shkaktohet nga një tërheqje muskulore, që vjen si rezultat i një pune të rëndë fizike, lëvizje të sforcuar, gjatë një sforcimi me ngritje peshe ose lëvizje e pakontrolluar, rrotullimi të trungut e më rrallë pas një rrëzimi, por dhe pas një qëndrimi të gjatë, të papërshtatshëm në këmbë ose ulur. Kushte të tjera që shkaktojnë dhimbjen e mesit janë stenoza spinale, artriti (osteoartriti), infeksionet spinale (osteomielitis), tumoret spinale dhe frakturat vertebrale. Pothuajse të gjithë do të përjetojnë dhimbje mesit në një pikë në jetën e tyre. Kjo dhimbje mund të variojë nga e lehtë në të rëndë. Ajo mund të jetë për një kohë të shkurtër ose afatgjatë. Mirëpo dhimbja e mesit mund të shkaktojë vështirësi për të bërë shumë aktivitete të përditshme. Njohja e shpinës dhe se si ajo punon mund të ndihmojë të kuptohet pse personi ka dhimbje mesit. Shpina është e përbërë nga eshtra të vogla, të quajtura rruaza, të cilat janë pirg në krye të njëra-tjetrës. Muskujt, ligamentet, nervat dhe disqet intervertebrale janë pjesë plotësisht të shpinës. Shtylla kurrizore është një formë kockor rezistent dhe i përkulshëm i përbërë nga një bashkësi vertebrale (rruazash), përgjithësisht 32 ose 34 dhe shtrihet nga baza e kafkës deri tek bishti. Ajo shërben si strukturë mbajtëse e organizmit, si vend për kapjen e muskuleve dhe si mbrojtëse e palcës kurrizore.

#### Simptomat

Dhimbja e mesit ndryshon. Ajo mund të jetë e mprehtë ose shpuase. Ajo mund të jetë e shurdhër, ose të ndihet si ngërc. Lloji i dhimbjes që keni do të varet nga shkaku themelor i dhimbjeve të mesit. Te shumica e njerëzve do të gjeni se mbështetja ose shtrirja do të përmirësojë dhimbjen e mesit, pa marrë parasysh shkaku themelor. Njerëzit me dhimbje mesit mund të përjetojnë disa nga këto. Dhimbja duket se kalon nga vithet, kofsha dhe këmba, gjer në shputën e këmbës. Madje, një tkurje e kolonës mund ta pengojë personin të përkulet përpara. Ndonjëherë dhimbja shkon deri në gju dhe faktori që e shkakton këtë nuk kuptohet lehtë. Dhimbja e mesit mund të përkeqësohet me përkuljen apo ngritjen (e peshave). Të ulurit mund të përkeqësojë dhimbjen. Qëndrimi në këmbë dhe ecja mund të përkeqësojë dhimbjen. Dhimbja e mesit vjen dhe shkon, e shpesh ndjek një kurs me ngritje dhe rënie me ditë të mira e ditë të këqija. Dhimbja mund të përhapet nga mesit në



Kujdes me peshat e rënda dhe sforcimet e tepërta! Simptomat kryesore të sëmundjes

## Njihuni me tri metodat kryesore që kurojnë dhimbjet e mesit

*Kur është e nevojshme ndërhyrja kirurgjikale*



vithe në zonën e jashtme të kofshës, por jo poshtë në këmbë. Nervi shiatic është i zakonshëm në një hernie diskale. Kjo përshhin vithet dhe dhimbjen në këmbë dhe madje, mpirje apo ndjesi shpimi gjilpërash, dobësi që shkon deri te këmbët (shputat). Është e mundur që të ketë dhimbje të nervit shiatic, pa dhimbje mesit. Pavarësisht nga moshja apo simptomat, në qoftë se dhimbja e mesit nuk përmirësohet brenda disa javësh, apo është e lidhur me ethe, të dridhura, ose humbje të papritur peshe, ju duhet të telefononi mjekun tuaj.



#### Mjekimi

Ekzaminimi fizik përfshin shikimin e shpinës dhe prekjen, për të zbuluar zonat e dhimbshme. Testet imazherike apo teste të tjera, të cilat mund të ndihmojnë mjekun për të konfirmuar diagnozën. Në përgjithësi, trajtimi i dhimbjes së mesit bëhet me njërin prej tri kategorive: medikamente, fizioterapi dhe kirurgji. Dhimbja e mesit mund të japë kufizim të aktiviteteve ditore të përditshme. Medikamentet dhe trajtime fizikale (fizioterapi) shpesh të kombinuara bashkë, lehtësojnë dhimbjet mjaftueshmërisht për të bërë të gjitha gjërat që ju doni të bëni.

#### Fizioterapia

Fizioterapia mund të përfshijnë modalitetet pasive, të tilla si: ngrohje, akull, ultrazëri, masazh dhe stimulim elektrik. Terapia aktive përbëhet nga ushtrime streçingu, ngritje peshash dhe ushtrimet kardiovaskulare. Ushtrimet e mesit për të rivendosur lëvizjen dhe forcën mund të jenë shumë të dobishme në lehtësimin e dhimbjes.

#### Operimi

Kirurgjia për dhimbjen e mesit duhet të konsiderohet vetëm kur mundësitë e trajtimit jokirurgjikal janë provuar dhe kanë dështuar. Është e mirë të provohen opsionet jokirurgjikal për 6 muaj deri në një vit, para se të merret në konsideratë kirurgjia.

**A**e keni përjetuar ndonjëherë ndjesinë sikur zemra do t'ju dalë nga kraharori? Po ndjesinë e zemrës që sikur resh të rrahuri për një sekondë? Ajo për të cilën po flasim ka të bëjë me rrahjet e shpeshta dhe të çrregullta të zemrës, një fenomen që zgjat krejt pak, por që mund të ndodhë shpesh, jo vetëm kur jeni në lëvizje, por edhe kur jeni ulur, shtrirë ose duke qëndruar në heshtje. Lajmi i mirë është që jo të gjitha rastet e rrahjeve të shpeshta të zemrës janë një tregues i një problemi shëndetësor që ka prekur këtë organ. Ndonjëherë, rrahjet e shpeshta të zemrës shkaktohen nga situatat kur zemra sforcohet nga stresi, sëmundjet, dehidratimi ose aktiviteti fizik. Shkaqe të tjera të rrahjeve të shpeshta të zemrës përfshijnë shtatzëninë, përdorimin e tepruar të kafeinës, simptoma të tjera mjekësore, marrja e ilaçeve apo duhanin dhe produktet e tij. Më poshtë po ju sjellim pesë mënyrat më të mira se si mund të mbani nën kontroll rrahjet e çrregullta dhe të shpejta të zemrës në kushtet e shtëpisë, ose kur ju duhet të vizitoni një mjek dhe mbi të gjitha për pasjen e një zemre të shëndetshme.

**1. Provoni teknikat e vetëqetësimt**

Stresi mund të shkaktojë ose përkeqësojë rrahjet e çrregullta të zemrës. Stresi dhe ekzaltimi i tepërt mund të rrisin nivelet e adrenalinës. Menaxhimi i stresit nëpërmjet vetëqetësimt ju vjen në ndihmë. Provoni të qëndroni ulur me këmbë të kryqëzuara dhe merrni frymë ngadalë me hundë dhe nxirreni nëpërmjet gojës. Përsëriteni këtë ushtrim disa herë deri sa të ndiheni më të qetë.

**2. Ushtrimet për stimujt nervorë**

Nervi vagus luan një sërë funksionesh, përfshirë atë të ndërlikjes së trurit me zemrën. Ushtrimet që kanë të bëjnë me këtë nerv e stimulojnë atë dhe ndihmojnë në rregullimin e rrahjeve të zemrës. Stimujt nervorë mund t'i bëni në shtëpi, por së pari duhet të merrni mendimin e mjekut. Bëni një dush të ftohtë. Shpëlarëni fytyrën me ujë të ftohtë ose vendosni mbi të një peshqir të lagur me ujë të ftohtë apo një kompresë për 20-30 sekonda. Shoku i të ftohtët ndihmon në stimulimin e këtij nervi.

**3. Pini ujë**

Dehidratimi mund të shkaktojë rrahje të çrregullta të zemrës, sepse gjaku përmban ujë dhe kur jeni të dehidratuar, gjaku trashet më shumë. Sa më i trashë gjaku, aq më fort duhet të punojë zemra deri gjatë atë nëpër vena. Puls i shtohet dhe rrahjet janë më të çrregullta dhe më të shpejta. Nëse e ndieni një gjë të tillë, pini një gotë me ujë. Nëse vini re se urina ka një ngjyrë të verdhë të errët, atëherë pini më shumë ujë për të shmangur rrahjet e shpeshta të zemrës.



# 5 këshilla për një zemër të shëndetshme e të fortë



**4. Riktheni ekuilibrit e elektroliteve**

Elektrolitet ndihmojnë në transmetimin e sinjaleve në të gjithë trupin. Disa prej elektroliteve që i bëjnë mirë zemrës janë kaliumi, kalciumi, magnezi. Shumica e këtyre elektroliteve merren më mirë nëpërmjet ushqimit. Avokado, bana-

nia, patatja e ëmbël dhe spinaqi janë burime shumë të mira të kaliumit. Nëse dëshironi të rrisni dozën e kalciumit, konsumoni më shumë barishte me ngjyrë të gjelbër dhe produkte bulmeti. Barishtet së bashku me arrorët dhe peshkun janë një burim i shkëlqyer i magnezit. Kujdes me kripën. Shumë njerëz marrin më shumë

kripë nëpërmjet ushqimeve të paketuara, produkteve të mishit dhe ushqimeve të shpejta.

**5. Shmangni stimuluesit**

Zemra është e ndjeshme ndaj substancave si:

Pijet dhe ushqimet me kafeinë. Alkooli i tepërt. Disa ilaçe kundër të ftohtët dhe kollës.

Ilaçet kundër oreksit. Ilaçet kundër sëmundjeve mendore.

Ilaçet kundër tensionit të lartë të gjakut.

Këto janë gjërat nga të cilat duhet të hiqni dorë ose të konsumoni më pak, nëse dëshironi që zemra të rrahë siç duhet.





# Këshilla

## Si të ulni nivelin e kolesterolit me fara luledielli

Farat e lulediellit janë të pasura me vitaminë E, B1, B3 dhe B6, si dhe kanë bakër, mangan, selen, fosfor, magnez dhe folate. Duke pasur një përmbajtje të lartë yndyrore, ato rrezikojnë të prishen lehtë, kështu që është mirë të ruhen në një enë hermetike në frigorifer.

### Përfitime kardiovaskulare dhe anti-inflamatore

Farat e lulediellit janë një burim i shkëlqyer i vitaminës E, antioksidantit më të madh në trupin tonë. Vitamina E neutralizon radikalet e lira, të cilat mund të dëmtojnë membranat qelizore dhe qelizat e trurit. Duke i mbrojtur këto komponentë qelizorë dhe molekularë, vitamina E ka efekte të rëndësishme anti-inflamatore, që rezultojnë në uljen e simptomave të astmës, osteoartritit, artritit reumatik dhe inflamacioneve të ndryshme. Është treguar gjithashtu se vitamina E ul rrezikun e kancerit të zorrës së trashë, peshës dhe shpeshësinë e afsheve të xehhta të gratë gjatë menopauzës. Vitamina E ndër të tjera luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare. Në fakt, ajo pengon ngjitjen e kolesterolit në muret e enëve të gjakut, duke nisur edhe procesin e arteriosklerozës, pra reagimin ndaj mundësive të ictuseve dhe infarktit në zemër.

### Veti kundër kolesterolit

Phytosterols është një komponent i pranishëm të farat e lulediellit dhe ka një strukturë shumë të ngjashme me atë të kolesterolit. Kur këto janë të pranishme në dietën e përditshme, ulin nivelet e kolesterolit në gjak dhe përmirësojnë reagimin imunitar të trupit, duke zvogëluar rrezikun për t'u prekur nga kancer të ndryshëm. Phytosterols gjendet në sasi të mëdha të farat e lulediellit, farat e kungullit, në farat e susamit, fistikët dhe arra braziliane.

### Mbron nervat, muskujt dhe enët e gjakut

Farat e lulediellit janë një burim i mirë i magnezit, i cili nga ana e tij zvogëlon peshën e astmës, ul presionin e lartë të gjakut, parandalon migrenën dhe zvogëlon rrezikun e goditjeve në zemër dhe infarkt. Magnezi është i nevojshëm për shëndetin e eshtrave dhe për prodhimin e energjisë. Rreth 2/3 e magnezit që gjendet në trupin e njeriut



është në eshtra. Magnezi balanon edhe kalciumin, duke e ndihmuar për të rregulluar ekuilibrin në nivelin nervor dhe muskuloz. Te qelizat nervore, magnezi shërben si antagonist i kalciumit, duke parandaluar që ky i fundit të aktivizojë qelizat nervore. Duke bllokuar hyrjen e kalciumit në qelizat nervore, magnezi mban nervat të qeta, për rrjedhojë edhe enët e gjakut dhe muskujt të ngjitura. Mungesa e magnezit mund të rrisë presionin e gjakut, spazmat e muskujve, dhimbjen e kokës, dhimbjen e barkut, tensionin dhe lodhjen.

### Parandalon kancerin dhe ka veti detoksifikimi

Farat e lulediellit janë një burim i mirë i selenit, një mineral thelbësor për shëndetin e njeriut. Seleni favorizon riparimin ADN-së dhe frenon e përhapjen e qelizave të kancerit. Nxit apoptozën, ose vetëshkatërrimin që trupi përdor për të eliminuar qelizat jonormale. Për më tepër, seleni bën pjesë edhe në përbërjen e një enzime antioksiduese, glutathione peroksidazës, e cila është veçanërisht e rëndësishme për mbrojtjen nga kanceri dhe është përdorur edhe te mëlcia për të parandaluar molekulat potencialisht të dëmshme.



## Luftoni hipertensionin me lëkurën e mollës

Hipertensionin konsiderohet të jetë një "sëmundje e heshtur", e cila sulmon jo pak njerëz në ditët e sotme për shkak të stresit, dietës së dobët dhe pirjes së duhanit. Disa nga simptomat më të zakonshme janë të vjellat, dhimbje koke të rënda, marrje mendsh dhe probleme me shikimin. Nëse keni një ose më shumë simptoma, vizitoni mjekun tuaj për diagnozë ose trajtim. Megjithatë, ju keni edhe zgjidhjet natyrale si një alternativë. Molla është padyshim një nga ato, pasi ka aftësinë për të ulur presionin arterial, sepse përmban flavonoide. Lëkura e mollës mund të ndihmojë rregullimin e hormoneve të lidhura me presionin tuaj të gjakut. Gjithashtu, parandalon vasokonstriktimin, që mund të sulmojë enët e gjakut. Përbërësit e gjelbër natyrorë që mund t'ju ndihmojnë kundër hipertensionit përfshijnë ekstraktin e lëkurës së mollës, qumështin dhe çajin e gjelbër. Këtu janë disa përfitime të tjera që ju mund të merrni nga konsumimi i lëkurës së mollës:

- Detoksifikon mëlcinë tuaj.
- Ul nivelin e kolesterolit të keq.
- Është plot me pektin, kështu që do t'ju ndihmojë të parandaloni hipergliceminë.
- Është plot me vitaminë B12, kështu që do t'ju ndihmojë kundër pagjumësisë.
- Ul ethe.
- Lufton kapsllëkun dhe diarrenë.
- Stimulon prodhimin e lëngjeve të stomakut, kështu që është e mahnitshme kundër ulçerës dhe gastritit.
- Lëkura e mollës është plot me fosfor, kështu që është e mahnitshme kundër problemeve me kujtesën. Konsumimi i lëkurës së mollës, të pjekur ose të papërpunuar, me lëngje, sallata ose si pure.



## TEATRI

# "Keqkuptimet" si alibi e personazheve të rreshtuar përkrah qeverisë

"Ku gaboi Elia Zaharia, princesha që thotë se doli kundër princit"

Nga Kastriot Çipi

Kolegia Elia Zaharia, një nga 64 firmëtarët e letrës së hapur, të nisur nga kolegu Artan Imami, është orvatur sot përmes një statusi në profilin e saj në "Facebook" të sqarojë "keqkuptimet" mbi zgjedhjen e saj. Me këtë shkrim po i jap shansin t'i sqarojë vërtetë gjitha keqkuptimet e mundshme, duke e ftuar t'u përgjigjet disa pyetjeve të thjeshta.

Ajo thotë se është kundër shembjes së ndërtesave të vjetra dhe për këtë sjell si shembull Piramidën (që në fakt është ndërtesë e re, vetëm 30-vjeçare) dhe thotë madje se në këtë rast, opinioni i saj është i kundërt me atë të bashkëshortit, Princit Leka. Do të ishte interesante të dinim mendimin e Princit Leka për çështjen e Teatrit Kombëtar, por ai ka zgjedhur të heshtë. As bashkëshortja e tij nuk na e thotë.

Më tej, ajo na siguron se do të ndjejë dhimbje kur të shembet Teatri Kombëtar, njësoj siç deklaronte pak ditë më parë edhe nismëtari i letrës në fjalë, kolegu Imami dhe poashtu, njësoj si ai, e vë theksin tek degradimi i ndërtesës.

Çuditërisht, kolegia Zaharia shprehet e vendosur pro dialogut me palëve pro e kundër shembjes, por nuk ka asnjë opinion për kryeministrin që i thirrur artistët, ndër të cilët edhe kolegen Zaharia, në kryeministri dhe u tha: "Teatri Kombëtar do të shembet. Mbledhja" që ka nisur para 20 vjetësh, mbaroi sot!"



Vallë ky është dialogu tek i cili beson kolegia Zaharia?

Pse nuk thotë një fjalë kolegia Zaharia për talebanen që kemi për ministere kulturore, që ka plot 5 muaj (8 shkurt - 8 korrik) që refuzon të takohet me kolegët e saj?

Nëse është pro dialogut, si ka mundësi që ka firmosur një letër të hartuar pas një dëgjese të vetme me artistët (dhe asnjë dëgjese me qytetarët) ku thuhet se: "Prej momentit kur mendimi i ekspertizës institucionale që ka lidhje me arkitekturën, inxhinierinë e ndërtimit, zjarfikësit etj., është shprehur në formë të qartë të lidhje me këtë çështje, çdo ditë që kalon është thjesht humbje kohë me debate të cilat mund t'i shërbejnë kujtdo, por jo interesave të publikut dhe Teatrit Kombëtar."? Kjo është ftesë për dialog apo kërkese për mblylljen e dialogut pa nisur mirë? Ku janë ekspertizat zyrtare që provojnë se ndërtesat e TK e TKE nuk mund të rindërtohen apo restaurohen?

Kolegia Zaharia na gënjehet entuziazmuar nga dëgjese farsa të kryebashkiakut, me drejtorët institucionesh,

klientët bashkie e artistët të mirëfinancuar me projekte nga ministria e bashkia. Ajo e quan moment entuziazmi edhe takimin e tre kolegëve me kryebashkiakun, por nuk na sqaron ku bazohet kur thotë se ata "ishin deleguar për të filluar negociatat, bashkëbisedimet konstruktive në emër të komunitetit"?!  
Atë që u trumbetua nga makina gëbelisiane e propagandës Rama-Velajti "marrëveshja me komunitetin e artistëve", kolegia Zaharia e përshkruan si "një rreze dielli në horizontin e trazuar të muajve të fundit". Si ka mundësi që nuk është njohur me deklaratat e Sindikatës së Artistëve të Skenës dhe Ekranit (SASE), ku ajo zyrtarisht është ende anëtare? Si ka mundësi që nuk i ka dëgjuar zërat e kolegëve, me qendër zërat, në sheshin e Teatrit, që ndodhet vetëm 50 metra në vijë ajrore nga Pallati Mbrëtëror?

Më tej, kolegia Zaharia bën një "ngatërrim të rëndë teksti" nga ata që u ndodhin ndonjëherë aktorëve në skenë dhe që e lenë "pa tekst" partnerin.

Ajo thotë se vetëm pasi u arrit kjo "marrëveshje" mes Veliajt dhe "komunitetit të artistëve", kolegu Imami përpiloi letërën e hapur. Në fakt, "teksti i autorit" thotë se kolegu Imami e lexoi letërën e hapur në fillim të dëgjësës së përbashkët me artistët e arkitektët, më 25 qershor, ndërsa "marrëveshja" me tre "përfaqësuesit e komunitetit" u arrit më 27 qershor.

Duke cituar pikë për pikë deklaratën e Veliajt për "marrëveshjen" në fjalë, kolegia Zaharia thotë se: "Artistëve iu premtua që asnjë centimetër nuk do të prekej nga sipërfaqja e teatrit... u fol për përfaqësues nga komuniteti, të cilët do të ndiqnin zhvillimet e mëtejshme... Bashkia u zotua të kërkonte modifikimet e duhura në interes të teatrit nga projekti i propozuar... të diskutohet integrimi apo ruajtja e pjesëve identifikuese si fasada apo rindërtimi i skenës sipas modelit të saj aktual".

Le të supozojmë për një çast se kolegia Zaharia dhe kolegë të tjerë të rreshtuar përkrah qeverisë janë keqkuptuar apo mashtruar nga deklaratat e z. Veliajt e mesditës së

27 qershorit. Atëherë pse nuk reagon kur projektligji i miratua nga qeveria po atë mbrëmje? Të nesërmen projektligji u bë publik dhe u depozitua në Kuvend. Ku janë në tekst zotimet e kryebashkiakut? Si ka mundësi që projektligji nuk ka as hartë, as referenca për sipërfaqet që do të negociohen? Veliaj, Kumbaro e më pas Ahmetaj kanë folur për 1156 m2 ndërtim të Teatrit Kombëtar. E beson vërtet kolegia Zaharia dhe kolegët e tjerë se sipërfaqja e Teatrit Kombëtar është kaq? Më e vogël se ajo e Turbinës? Po sipërfaqja e Teatrit Kombëtar Eksperimental, sa është? Po oborri, pishina dhe zdrukthëtaria? Po trualli i parkingut të Bashkisë? Po "Fusha shpk." me m2 truall po investon në këtë sipërmarrje? Po vlerën 30 milionë euro të teatrit të ri kush e llogarit?

Duke iu rikthyer letrës së hapur të kolegut Imami, kolegia Zaharia na thotë se: "Asnjë rresht në letërën e tij të hapur nuk përmend shembjen e teatrit... Nuk mendoj se është mëkat të kërkojmë parametra dhe kapacitete europiane në një teatër dinjitoz kombëtar... Nëse është e mundur të ndërtohet ky teatër i ri modern, dhe krahas tij të restaurohet apo rikonstruktohet ai ekzistues, kjo do të ishte një zgjidhje ideale dhe ne të gjithë do të ishim shumë të lumtur!". Pyetja në këtë rast është pse kolegia Zaharia dhe 63, 66 apo 67 kolegët e tjerë nuk e nënshkruajnë letërën e hapur të 130 kolegëve të tjerë që kërkojnë pikërisht këtë gjë: ndërtimin e teatrit të ri DHE rindërtimin apo restaurimin e teatrit të vjetër?

Së fundi, nuk mund të le pa përmendur aspektin ligjor të

kësaj afere mafioze. Edhe për këtë do të doja një përgjigje nga kolegia Zaharia, këtë herë në cilësinë e saj si princeshë e kurorës. Nëse Shqipëria do të ishte mbretëri dhe ajo do të ishte mbretëresha e Shqipërisë, a do të dekretonte ajo një ligj special, me procedurë të përshtetshme, që anashkalon katër ligje të tjerë, MSA dhe Kushtetutën e Shqipërisë? Kam frikë se po, nëse është e vërtetë ajo që thuhet në media, se familja princërore ka marrë një leje ndërtimi në sheshin midis hotel "Dajti" dhe Katedrales së Shën Palit.

E dashur kolege Zaharia, të dashur kolege që keni nënshkruar apo jeni shprehur publikisht pro ligjit special antikushettes të qeverisë, mos ufishini prapa gishtit. Keni pranuar që ndërtesat historike të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental të shembet, që 8 mijë m2 truall publik të shkëmbehen me një ndërtim që vlen shtatë herë më pak, që vendimet për trashëgiminë historike dhe kulturore t'i marrë një individ i vetëm: kryeministri! Shkurt, keni pranuar që Shqipëria të jetë diktaturë, apo monarki absolute, cillindom term të keni më për zemër. Nëse një ditë pendoheni për qëndrimin tuaj, Letra e Hapur e artistëve që kërkojnë ndërtimin e teatrit të ri, paralelisht me restaurimin apo rindërtimin e teatrit të vjetër, do të jetë e hapur për firmat tuaja. Deri atëherë, shijoni përfitimet që ju jep afërsisht me pushtetin dhe kursjejin alibitë e rreme me keqkuptime e keqinterpretime.

## Teatri i keqkuptimeve

Nga Elia Zaharia Zogu

Ata që më njohin, e njohin gjithashtu shumë mirë ndeshmërinë time absolute ndaj ndërtesave historike, qofshin këto institucione apo shtëpi e vila private.

Në kohën e debatit të ashpër për prishjen e piramidës, unë ndjeja keqardhje për të gjitha herët që si fëmijë rrëshqitja në faqet e saj të mermerit. I përkas një brezi që nuk e lidh godinën me motivacionet fillestare të

ndërtimit. Edhe sot kur e shoh, pyes veten përse të mos rikonceptohet kjo ndërtesë si një qendër Pompidou, ku artistët bashkëkohorë të shprehën në forma alternative, të organizohen ekspozita, performanca, të ketë një bibliotekë të integruar etj. Dëshiroj të theksoj këtu që bashkëshorti im, Princ Leka ka mendim kategorikisht të kundërt me mua për piramidën, por fatmirë-

*Sqarimi i aktore dhe princeshës për firmën që hodhi pro shembjes*

sisht në familjen tonë ka demokraci dhe secili mund të shprehë lirshëm mendimin e tij.

Ai apo ajo që mendon se nuk më dhemb akoma më shumë Teatri Kombëtar, me siguri nuk e di që unë kam qenë në atë skenë përpara se të vij në jetë. Mamaja ime interpretonte "Natën e Dymbëdhjetë" të Shekspir-it me mua shatzenë. E gjithë fëmijëria ime lidhet me atë ndërtesë,

me atë skenë. Kur shoqet e mia luanin në sheshet përpara pallateve, unë luaja në oborrin e atij teatrit. Pikërisht magjia e asaj skene dhe e asaj atmosfere më ushqyen ëndrrën e jetës sime për t'u bërë aktore. Ajo godinë, e cila nuk u ndërtua për t'u mbijetuar viteve, prapëseprapë i mbijetoi duke i dhënë vendit art dhe dritë në kohët e tij më të zymta. Në atë skenë vite më vonë kam

marrë emocione të pazëvendësueshme si artiste. Sigurisht që teatri është magji dhe ajo skenë që ka mbajtur kulosët e artit shqiptar e mbart këtë magji.

Çështja e Teatrit Kombëtar është sigurisht shumë e ndjeshme për çdo qytetar, por kryesisht për artistët që performojnë në të. Këtu nuk flas për ndërtesën si trashëgimi kulturore, e cila padyshim i përket çdo shqiptari, por

për kushtet e punës, funksionalitetin dhe kapacitetet që kjo godinë ka për të ofruar sot. Askush nuk mund të mohojë degradimin ekstrem të godinës dhe bërjen pothuajse të pamundur të ushtrimit të veprimtarisë artistike në kushtet aktuale. Në pothuajse tri dekada lënie në harrësë, artistët dhe publiku artdashës nuk e kanë braktisur kurrë, por i kanë dhënë shpirt një ndërtesë të lënë në agoni.

Sot dëgjoj shumë zëra intelektualësh të respektuar që dalin në mbrojtje të godinës së teatrit dhe singlerisht kjo më prek shumë. Më në fund, pas kaq shumë vitesh, teatri ka vëmendjen që ka merituar gjithmonë! →





Elia Zaharia Zogu

11 orë · C

Teatri i Keqkuptimeve

Ata që më njohin e njohin gjithashtu shumë mirë ndjeshmërinë time absolute ndaj ndërtesave historike, qofshin këto institucione apo shtëpi e vila private.

Në kohën e dabit të ashpër për prishjen e piramidës, une ndjeja keqardhje për të gjitha herët që si femijë rreshkisja në faqet e saj të mermerta. I përkas një brezi që nuk e lidh godinën me motivacionet fillestare të ndërtimit. Edhe sot kur e shoh pyes veten përse të mos rikonceptohet kjo ndërtesë s...

Vazhdo leximin



← Të njëjtën vëmendje kanë merituar edhe artistët e mëdhenj, që i kanë dhënë kësaj godine kuptim dhe histori. Edhe ata kanë merituar të punojnë e krijojnë në kushte njerëzore, të vlerësohen konkretisht për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm. Publiku i ka duruar artrokitur nga zemra, ndërkohë që shëndeti i tyre degradonte nga mungesa totale e kujdesit për ta! Disa prej tyre ndërruan jetë pasi nuk patën mundësi të përballojnë shpenzimet e kurimeve, pas një jete dedikim në Teatrin Kombëtar!

Sigurisht, idealja do kish qenë që i gjithë ky debat të mos kishte nevojë për protesta, për akuzë e kundërrakuzë, por për tavolina të rrumbullakëta, si ajo e Mbretit Artur, ku të gjitha palët të ishin të barabarta në të drejtën e tyre legjitime për të diskutuar mbi të ardhmen e ndërtesës dhe institucionit.

Unë personalisht kam qenë gjithmonë pro dialog, kjo është natyra ime, pasi ende besoj se dialogu është e vetmja rrugë drejt zgjidhjes përfundimtare të problemeve të një shoqërie.

Pas disa muajsh këto tryeza të përbashkëta filluan të organizohen dhe unë së bashku me shumë kolegë shprehëm entuziazmin tonë që më në fund palët u ulën dhe filluan të kërkonin bashkërisht zgjidhjen e problemit.

Debati për të ardhmen e Teatrit Kombëtar, i cili zgjat prej disa muajsh tashmë, herë na ka bashkuar e herë na ka vendosur në kafe të kundërt, ose është interpretuar si i tillë për shkak të mosinformimit apo nxitimit.

Një moment entuziast për mua ishte takimi mes bashkës dhe tre kolegëve të nderuar, të cilët ishin deleguar për të filluar negociatat, bashkëbisedimet konstruktive në emër të komunitetit. Pasi u

lajmërua një bazë e shëndetshme për fillimin e negociatave, ku artistëve u premtua që asnjë centimetër nuk do të prekej nga sipërfaqja e teatrit dhe ai do të rindërtohej në territorin aktual, ku gjithashtu u fol për dy përfaqësues nga komuniteti të cilët do të ndiqnin zhvillimet e mëtejshme, pasi bashkia u zotua të kërkonte modifikimet e duhura në interes të teatrit nga projekti i propozuar, (këtu mund pse jo të diskutohet integrimi apo ruajtja e pjesëve identifikuese si fasada apo rindërtimi i skenës sipas modelit të saj aktual), atëherë u duk një rreze dielli në horizontin e trazuar të muajve të fundit.

Vetëm atëherë, kolegu ynë Artan Imami përpiloi një letër të hapur, në të cilën shprehu mbështetjen për këtë marrëveshje si edhe nevojën e një Teatri të Ri Kombëtar, duke vënë theksin mbi mosprekjen e territorit. Asnjë rresht në letërën e tij të hapur nuk përmend shembjen e teatrit, por nevojën imediate për një teatër të ri dinjitoz me parametra europianë, për nga kapacitetet dhe funksionaliteti.

Kjo kërkesë mëse legjitime vjen nga një komunitet, i cili për dekada me radhë është braktisur dhe lënë të bëjë art në kushte të papranueshme. Unë padyshim si artiste dhe art-dashëse e mbështes këtë nevojë, pa pasur nevojë të firmos asnjë peticion, siç disa u nxituan të më akuzojnë, pasi mbështes jo vetëm të kaluarën e ndritur që e ka shkruar trashëgiminë artistike me gërma ari, por edhe të ardhmen e brishtë të artistëve shqiptarë. Nuk mendoj se është mëkat të kërkojmë parametra dhe kapacitete europiane në një teatër dinjitoz kombëtar. Do dëshiroja që komuniteti artistik të krijojte në teknologji moderne, të ecte paralel me vendet e zhvilluara. Nëse është e mundur, të ndërtohet ky

teatër i ri modern dhe krahas tij të restaurohet apo rikonstruktoret ai ekzistues, kjo do të ishte një zgjidhje ideale dhe ne të gjithë do të ishim shumë të lumtur! Por sa reale është në kushtet e sotme kjo dëshirë e jona? A i përmbush godina e sotme këto parametra? Këtë përgjigje ata që e njohin sadopak teatrin në brendi, e dinë. Ata që e kanë parë vetëm nga fasada apo në televizor, i ftoj ta vizitojnë. Për një gjë isiguroj të gjithë ata që i kanë ndarë me dashje artistët në "me ne ose kundra nesh", nuk ka asnjë artist që nuk e do apo nuk i dhëmb Teatri Kombëtar, përkundrazi! Të gjithë jemi teatrit!

Për ata që përmenden Mbretin Zog, po i siguroj për një gjë, nëse Shqipëria do të ishte mbretëri, ai Teatër Kombëtar nuk do kishte degraduar kurrë në atë pikë. Dhe sigurisht do ishin ndërtaur shumë të rinj me parametra të kohës, kështu regjisorët do kishin mundësi të zgjidhnin sallat në funksion të dramaturgjisë. Unë vetë kam pasur rast të shoh në një botim të kohës, një projekt të Mbretërisë për Teatrin Kombëtar. Bëhej fjalë për një ndërtesë madhështore pranë Kishës Katolike në Rrugën e Kavajës. Por fati vendosi një tjetër rrugë të mundimshme për këtë vend!

Pyetja që unë shtroj sot për të gjithë artistët e brezit të ri është, a do të mundemi ne t'i japim shpresë dhe dritë vendit tonë? A do mundemi ne të bëjmë atë që bënë paraardhësit tanë? Të frymëzojmë! Sigurisht jo, duke luftuar njëri-tjetrit! Miq artistë, politikant shkojnë e vijnë, ne kemi njëri-tjetrin dhe do vazhdojmë të krijojmë e punojmë bashkë. Ndaj ju lutem mos pranoni përçarjen dhe armiqtësinë, por të gjithë bashkë për t'i dhënë vendit art dhe dashuri!

# “Shpirtrat e lirë nën 33° celsius dhe kartonët e çingijeve të turpit”

Teatri, regjisor kritikon deputetët që firmosën ligjin duke nënvlerësuar protestën

Nga Bujar Alimani

Protesta e mbrojtëseve të kauzës së Teatrit Kombëtar nuk kishte sharm”, shkruante një punonjëse e Ministrisë së Kulturës në faqen e saj në 'FB'. E vërtetë.

Nuk kishte në protestë regjisorë. Dua të them regjisorë si ata që përgatisin mitingjet e partive. Ose dasmat e sotme. Me pult komandimi. Montazhierë. Drejtorë fotografish. Koloristë. Operatorë zëri.

Protesta përpara Parlamentit Shqiptar nuk kishte platformë regjisoriale. Nuk kishte plane të marra me dron nga sipër. Me kran, ashtu si mbrëmja e përrimit të 'Turbinës' së çingijeve, ku planet uleshin e ngriheshin e tregonin të njëjtën gjë. 'Turbinën', kryeministrin dhe çingjet e mbrëmjes.

Protesta para Parlamentit nuk kishte kostumierë. As dekoratorë. Letrat në duart e djesiturave ishin letra të zakonshme "Unë jam Teatri" të shkruara me marker, lapsa a stillolapsa.

Një altoparantë i thjeshtë që kalonte dorë më dorë. Veshur si çdo ditë.

Edhe pse e dinin se aty brenda atij Parlamentit një turp më tepër do shënohej. Por ishin aty. Përballë turpit. Gjëja e



fundit që u interesonte ishte i ashtuquajturit sharm. Madje, askush nuk është i interesuar edhe ta xhirojë, duke u distancuar nga kjo. Nuk u ka shkuar në mendje as të përfitojnë e që mund kohë më vonë të bëjë një dokumentar të shkëlqyer. Dhe kjo, për një fakt të thjeshtë - sepse janë të gjithë të përfshirë. Kokë e këmbë në mbrojtje të Teatrit. E kështu, si në shfaqjet e pafilluara kurrë, legjendat për aktorët tanë të mëdhenj marrin përmasat e eposit, ashtu dhe mosfilmimet e "pakujdesjet" e këtyre ditëve janë shenja të përfshirjes që i bëjnë ata sot e nesër heroj. Ndryshe nga rrogetarët që flasin për mungesë sharmi të protestës.

Protesta e qytetarëve para Parlamentit të Sh-

qipërisë nën diellin që digte ishte nga ato protestat zonjë, që të kujton majin e 1968 në Francë. Të kujton Qytetin Studenti në Tiranë, në dhjetor të 1990. Atëherë as protestat tona edhe kur rrezuam shtatoren e diktatorit nuk kishin "sharmin" që thua ti. Por ashtu si sot, edhe atëherë dhe gjithmonë sharmet një kauze nuk ia japin planet nga sipër, ngjyrat apo misanskenat. Sharmi është shpirti i së drejtës, vështrimi drejt, denoncimi i padrejtësisë e vjedhjeve.

Ashtu i djesitur nën 33 grade celsius, pra, në Tiranë që digte, portreti plot sharm e dritë i Neritan Liçajt ishte e do mbetet padyshim më i rëndësishëm se 75 kartonët e turpit të çingijeve tuaj.

SHKURT

## Shkrimtari i njohur u dërgon letër 27 ministrave të Kulturës së BE për teatrin

Shkrimtari i njohur, Rudi Erebara u ka dërguar letër 27 ministrave të Kulturës së Bashkimit Evropian, në lidhje me synimin e qeverisë "Rama" për të prishur Teatrin Kombëtar. Rudi Erebara është fitues i Çmimit Europian të Letërsisë për romanin e tij të fundit "Epika e yjeve të mëngjesit". "Me prishjen e Teatrit Kombëtar, Shqipëria humbet një monument historik të një rëndësie unike historike dhe arkitekturore, vatrën e prodhimit të teatrore nga viti 1947, një kompleks unik arkitektonik dhe gjithashtu një shembull të arkitekturës racionaliste italiane



të viteve '30 të shekullit të kaluar. Ajo çka pritet të ndodhë është një shembull tjetër i shkatërrimit të historisë nga zyrtarët e korruptuar në partneritet me firmat private si dhe partisë-shitet në fuqi, që jehon his-

torinë endemike të totalitarizmit, i cili shkaktoi viktima të panumërta si dhe humbje njerëzore dhe kulturore si dhe terror fizik dhe psikologjik për shqiptarët", shkruan Rudi Erebara.

Opinion i Ditës

# MASR nevojitet të rishikojë normat e punës mësimore në arsimin parauniversitar

Nga Zija Lika

(Vizion nga faqja e parë)

...në sistemin arsimor parauniversitar të vendit tonë, përmirësimi të akteve përkatëse ligjore e nënligjore me synim funksionimin sa më normal, eficient e me cilësinë e kërkuar të këtij sistemi, po paraqes disa mendime dhe sugjerime, në funksion të rishikimit të normave të punës mësimore - edukative dhe numrit të nxënësve për klasë në arsimin e mesëm të lartë, të përcaktuara në udhëzimin në fuqi nr. 44, datë 16.10.2014 të MAS.

Në bazë të udhëzimit në fuqi nr. 44, datë 16.10.2014 të MAS, për disa ndryshime në udhëzimin e MASH nr. 21, datë 23.07.2010, "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar", pika L2(b), mësuesi i lëndëve Histori- Gjeografi e ka normën punës mësimore javore 20 orë mësimore, ndërsa sipas pikës L2(c) mësuesi i lëndëve të tjera si: Ekonomi, Qytetari, Filozofi, Sociologji, Psikologji e Teknologji e ka këtë normë të barabartë me 22 orë mësimore.

Mendoj se norma e punës mësimore javore e mësuesit përkatës të këtyre lëndëve, në varësi me analizimin realist, profesional e kompetent të çdo rasti konkret duhet të barazohet me atë të mësuesit të Histori- Gjeografisë (20 orë mësimore), ose të paktën duhet të ulët 1 orë mësimore, duke u bërë 20 ose 21 orë mësimore në javë nga 22, pasi nuk ekziston arsye dhe argumente thelbësorë, që të justifikojnë këtë diferencë aktuale prej 2 orësh më shumë.

Arsyetimi i mundshëm për shembull, se lënda e Ekonomisë zhvillohet vetëm në klasën e 12 të gjimnazit dhe programi mësimor vjetor në këtë rast zgjat 34 javë, nga 36 që zgjat për klasat 11 e 12, qëndron pjesërisht duke e justifikuar maksimalisht deri në 1 orë mësimore më shumë normën e punës mësimore javore të mësuesit përkatës dhe jo 2 të tilla.

**Në mbrojtje të asaj ç'ka themi, po argumentojmë si më poshtë:**

"Norma e punës mësimore vjetore për mësuesin e lëndëve: Histori, Gjeografi në kushtet kur jep mësim vetëm në klasat 10 e 11, (ndërkohë që kjo gjë ndodh shumë rrallë, pasi ai përgjithësisht jep mësim njëkohësisht edhe në klasën e 12) është maksimalisht 720 orë mësimore = 36 x 20. Nëse mësuesi i lartpërmendur jep mësim vetëm në klasën 12 (kur ka shumë paralele), apo përveç klasave 11, 12 edhe në atë 12, ngarkesa e mësimitore vjetore e mësuesit të këtyre lëndëve, varion nga 680 orë deri në më pak se 720, në varësi të numrit të orëve mësimore që jep edhe në klasën e 12, të llogaritura me 34 javë mësimore të kohëzgjatjes së programit mësimor vjetor.

"Nga ana tjetër, norma e punës mësimore vjetore për mësuesin e lëndës Ekonomik, bazuar në udhëzimin e lartpërmendur në fuqi nr. 44, datë 16.10.2014 të MAS, është 748 orë mësimore = 34 x 22, ose e thënë ndryshe 28-68 orë mësimore më shumë në



varësi me rastin konkret, krahasuar me mësuesin e sipërcituar të lëndëve Histori, Gjeografi.

"Pa dashur të nënvlerësoj rëndësinë e zhvillimit në gjimnaze të lëndës "Edukimi Fizik, Sporte dhe Shëndeti", ku mësuesi përkatës e ka normën e punës mësimore javore 22 orë mësimore, gjykoj se mësuesi i lëndëve Ekonomi, Qytetari, Filozofi, Sociologji, Psikologji e Teknologji, duhet ta ketë sipas rasteve konkret 1-2 orë mësimore më pak, normën e punës mësimore javore, nga 22 orë që vazhdon të jetë aktualisht. Në lidhje me këtë mjafton të përmend faktin se mësuesi i lëndës "Edukimi Fizik, Sporte dhe Shëndeti" zhvillon orën mësimore vetëm me gjysmë klase (veç djemtë nga vajzat sikurse dihet) dhe për rrjedhojë investon më pak kohë efektive pune përgjatë orës mësimore për realizimin e procedurave përkatëse mësimore në lidhje me trajtimin dhe vlerësimin e nxënësve sipas linjave respektive (i vazhduar, me test/detyrë të përmblidhëse dhe portofol), regjistrimin e të dhënave, plotësimin e dokumentacionit përkatës, e të tjera, ndërkohë që nisur nga karakteri më shumë praktik sesa teorik i kësaj lënde, koha dhe angazhimi gati i përditshëm (zakonisht pas orarit zyrtar të punës), që i nevojitet mësuesit për t'u përgatitur në këtë lëndë për zhvillimin normal të procesit mësimor të ditës pasardhëse është relativisht më i vogël nga koha përgatitore, studimore, angazhimi i nevojshëm e të tjera, që i duhet çdonjërit prej mësuesve të lëndëve të lartpërmendura, në funksion të realizimit efektiv e me cilësinë e kërkuar të qëllimit të sipërcituar. Nga ana tjetër, në periudhën e deritanishme (sikurse është bërë më parë e njohur nga media të ndryshme qendrore apo lokale vendëse), një pjesë jo e vogël e institucioneve arsimore parauniversitare në shkallë vendi (përfshirë edhe ato të arsimit të mesëm të lartë), kanë pasur vetëm pjesërisht ose jo, mjediset e nevojshme e të përshatshme për zhvillimin sipas standardeve dhe cilësisë së kërkuar, të orëve mësimore në lëndën "Edukimi Fizik, Sporte

dhe Shëndeti", veçanërisht përgjatë ditëve mësimore me kushte të pafavorshme klimatike.

"Ndodh jo rrallë që mësuesi i emëruar me kohë të plotë pune, me qëllim që të plotësojë normën përkatëse javore të punës mësimore-edukative, ngarkohet të zhvillojë orë mësimore në lëndë të ndryshme, tek të cilat ai është brenda profilin të kërkuar, ose të përafërt në përputhje me aktet përkatëse ligjore e nënligjore në fuqi të MASR, por nga ana tjetër ato lëndë iu përkasin aktualisht normave të ndryshme të punës mësimore javore, sipas përkatimeve të bëra në udhëzimin në fuqi nr. 44, datë 16.10.2014 të MAS. Në këtë rast ky udhëzim apo ndonjë tjetër në fuqi, nuk jep formulën apo rregullin e përcaktimit të saktë të normës së punës mësimore-edukative.

Kështu për shembull, në kushtet e përcaktimit ligjore në fuqi, nëse një mësues në varësi me profilin e tij ngarkohet të zhvillojë orë mësimore të lëndëve: "Histori, Qytetari", "Matematikë, Teknologji", "Gjeografi, Sociologji", "Histori, Gjeografi, Filozofi, Ekonomi" e të tjera kombinime të lejueshme lëndësh, me norma të ndryshme të punës mësimore javore, atëherë kush do të ishte saktësisht norma e punës mësimore javore për këtë mësues?

Në këtë rast me synimin për të qenë sa më të saktë në përcaktimin e normës së punës javore mësimore-edukative, pasi me këtë tregues lidhet drejtpërdrejt mënaxhimi efektiv i burimeve njerëzore arsimore, pagesa financiare normale dhe /ose suplementare, mendoj se lind e nevojshme të përllogarit norma e lartpërmendur e trajtës së ndërmjetme. Një ndër formulat përkatëse që unë sugjeroj për të llogaritur normën ndërmjetëse javore të punës mësimore-edukative (Nnp), kur mësuesi në përputhje me profilin e kërkuar apo të përafërt, ngarkohet të zhvillojë lëndë që u përkasin dy normave javore të ndryshme pune: N1, N2, ku (N1 < N2), jepet si më poshtë:  $Nnp = [n1 + (N1 - n1) \times N2 / N1] = (n1 + n2)$ ; nga rrjedh se:  $(n1 / N1 + n2 / N2) = 1$

ku: n1 - numri i orëve mësimore javore, që mësuesi ngarkohet për t'i zhvilluar në lidhje me lëndën/ lëndët, me normën e punës javore N1 dhe  $(N1 - n1) \times N2 / N1 = n2$  - numri i orëve mësimore javore, që mësuesi ngarkohet për t'i zhvilluar në lidhje me lëndën/ lëndët, me normën e punës javore N2. Në ngjashmëri me formulën e mësipërme, mund të ndërtohet formula përkatëse në referim të rasteve që ndodh më rrallë, kur mësuesi në përputhje me profilin e kërkuar apo të përafërt, ngarkohet të zhvillojë lëndë që u përkasin tri normave javore të ndryshme pune: N1, N2, N3, ku  $(N1 < N2 < N3)$ . Edhe në këtë rast prej kësaj formule, do të plotësohej relacioni si më sipër:  $(n1 / N1 + n2 / N2 + n3 / N3) = 1$ .

Sqarojmë se në të gjitha ato raste kur treguesi "Nnp", është numër dhjetor, atëherë ai rrumbullakoset i plotë bazuar në rregullin përkatës matematikor, në funksion të shpërndarjes midis mësuesve të normave respektive javore mësimore në prag të fillimit vitit përkatës shkollor, ndërsa për efekt të llogaritjes së normës vjetore të planifikuar të punës mësimore-edukative (veçanërisht në rastet e kryerjes së pagesave financiare për realizim orësh suplementare), ky tregues duhet të merret saktësisht aq sa rezultojnë nga përllogaritjet përkatëse. Në lidhje me situatat e problematikat e ndryshme, që mund të shoqërojnë përcaktimin e saktë të normave javore të punës mësimore-edukative për mësuesit e cilit të mesëm të lartë, konstatohet se nëni 105 i dispozitave normative, hartuar e miratuar në zbatim të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH", ndërsa është i zbatueshëm për tri lëndët përkatëse: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Gjuhë e Huaj e Parë dhe Matematikë (të cilat kanë qenë dhe do vazhdojnë të jenë provim i detyruar i maturës shqiptërore për nxënësit e klasës 12), për lëndët e tjera, të cilat zgjidhen nga nxënësit për t'u dhënë provim me zgjedhje në Maturën Shqiptërore, pika nr. 2 e këtij neni ku në të cilën citohet se: "Orët e konsultimeve i përkasin ngarkesës vjetore të mësuesit", nuk mund të zbatohet gjatë gjithë vitit shkollor, për sa i takon përfshirjes së orëve të konsultimeve në këto lëndë, në normën e planifikuar javore të punës mësimore të mësuesit, pasi këto lëndë zgjidhen apo nuk zgjidhen për provim mature shtetërore nga nxënësit, të paktën 6 muaj mbraja çdo fillim viti shkollor. "I motivuar nga dëshira dhe obligimi për të pasur arritje cilësore dhe rezultate komplekse sa më të larta, në fushën e zbatimit të reformës së re arsimore-kurrikulare në gjimnaze (e cila në vitin e ardhshëm shkollor 2018-2019 e vazhdim do të funksionojë në të tre vitet e tij), mendoj se gradualisht në të ardhmen, në varësi të kapaciteteve buxhetore financiare në dispozicion të arsimit publik parauniversitar, duhet shikohet me përparësi dhe realizohet

mundësia e uljes së numrit të nxënësve për klasë, krahasuar me kriterin përkatës të përcaktuar në udhëzimin në fuqi nr. 44, datë 16.10.2014 të MAS, pika 4.a, ku në të cilën citohet se: "Klasat në gjimnaze formohen me 30-35 nxënës". Përvoja e deritanishme e një pjesë jo të vogël mësuesish të gjimnazëve të ndryshme (kryesisht të rretheve jugore të vendit), me të cilët kontaktoj dhe/ose mbaj marrëdhënie bashkëpunimi pune, shkëmbimi eksperiencash profesionale e të tjera, si dhe opinionet e ndryshme të dhëna në shumë më të vendit nga prindër, nxënës gjimnazistë, apo intelektualë të tjerë njohës të problematikave arsimore tregojnë se zbatimi i reformës së re arsimore - kurrikulare në gjimnaze ka rritur ndjeshëm në krahasim me më parë, volumnin dhe kohën e punës që duhet të investojë mësuesi dhe nxënësi. Nëse ky konstatim arrihet të provohet në shkallë vendi, atëherë gjykoj se ulja graduale në të ardhmen e numrit të nxënësve për klasë (sikurse themi më sipër), deri në një nivel optimal të arsyeshëm në përputhje me studimet përkatëse paraprahe dhe që mund të përballohet nga buxheti përkatës financiar shtetëror, do të krijojë më shumë mundësi për arritjen e rezultateve më të mira e cilësore, në aspektin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe treguesve të tjerë të rëndësishëm arsimorë. Nga ana e tjetër, në të ardhmen, mbështetur në përvojat e ngjashme ndërkombëtare e të suksesshme bashkëkohore, studimet përkatëse të institucioneve shkencore vendëse apo të huaja dhe anketimet apo marrjen e mendimeve të mësuesve, nxënësve, prindërve e të tjerë duhet të shikohet mundësia e zvogëlimit ose eliminimit nga programet mësimore (në dobi të nxënësve), të ngarkesave të tepërta e të padobishme mësimore, që mund të konstatohen në lëndë të ndryshme. "Nisur nga sa më sipër, duke qenë se problematika e përcaktimit të saktë të normave javore të punës mësimore - edukative, të mësuesve në sistemin arsimor publik parauniversitar (cikli i mesëm i lartë), është tepër e rëndësishme për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore arsimore dhe kapaciteteve përkatëse intelektuale, në mënyrë që çdokush të ngarkohet me punë dhe shpërblehet financiarisht në masën që i takon, gjykoj se këto mendime e sugjerime apo të tjera që mund të ketë, duhet të analizohen me realizim e kompetencë profesionale, si dhe të merren në konsideratë, në funksion të rishikimit të normave të punës mësimore - edukative dhe numrit të nxënësve për klasë, të përcaktuara në udhëzimin në fuqi nr. 44, datë 16.10.2014 të MAS.



Opinioni *i* Ditës

# Teatri absurd dhe transparenca e munguar e partisë-shtet

Nga Rezana Konomi

(Vijon nga faqja e parë)

...të ndaj shqetësimin tim qytetar me të tjerët, por sidomos për të balafaqur opinionet personale, si një mënyrë konfirmimi ose jo të ideve që vijjnë dhe ikin sipas rastit. Shpesh ka ndodhur, sidomos kohët e fundit që ngjarjet dhe dukuritë kanë një shpeshësi të tillë sa nuk arrijmë të kuptojmë çfarë ka ndodhur me të parën, sepse radha e së dytës nuk lë vend për hamendësime dhe "teori konspirative", për të cilat të gjithë jemi të gatshëm të thurim plane dhe të nxjerrim përfundime të vërteta ose jo.

Debatit aktual për prishjen apo mosprishjen e Teatrit Kombëtar sa i hershem, aq edhe aktual nuk është çështja e vetme e ditës, e cila ka zgjaur vetëdijen qytetare, por më shumë se kaq ka nxjerrë në pah një problematikë që lidhet me transparençën e munguar të pushtetit në vendimmarrjet, të cilat kanë një interes publik dhe për këtë shkak llogaridhënia dhe informimi merr një rëndësi parësore në një shtet demokratik.

Parimi i transparencës është një domosdoshmëri në një shtet të së drejtës, një detyrim jo vetëm moral kundrejt sovranit, por mbi të gjitha është një detyrim ligjor. Në çështjen e ditës të prishjes ose jo të Teatrit Kombëtar, në mungesë të një informacioni të plotë dhe të saktë, unë nuk guxoj të marr përsipër gjykimin nëse duhet ose nuk duhet, sepse për këtë dua të besoj tek mendimi i ekspertëve, të cilët duhet të kenë monopolin e së vërtetës, zhveshur nga çdo interes partiak dhe jashtë çdo konflikti interesi. Në gjithë këtë debat, ku gjithkush merr rolin e demonit, ajo që duhet të na shqetësojë të gjithëve është mungesa e transparencës nga organet vendimmarrëse, në mënyrë që ndërgjegjësimi dhe çdo hap që ndërmerret në funksion të një plani zhvillimor të qytetit të jetë rezultat i një konsultimi publik, sepse vepra të tilla kanë një interes publik, mbartin një memorie, kanë sensibilitet të lartë emocional, por jo vetëm.

Transparenca e institucioneve publike vendore është thelbësore për të rritur përgjegjshmërinë e këtyre institucioneve ndaj qytetarëve. Ne të gjithë si qytetarë e takapagues kontribuojmë me paratë tonë në funksionimin e këtyre organizmave dhe për këtë arsye interesi publik për t'u informuar rreth mjeteve të shpenzimit të këtij kontributi është e drejtë dhe detyrim. Aksesit në informim, sidomos kur bëhet fjalë për vepra të tilla, sikurse është Teatri Kombëtar bën të mundur evidentimin e mangësive të mundshme të efikasitetit në qeverisje, duke krijuar mundësi vlerësimi dhe përmirësimi për një menaxhim sa më të mirë



të shërbimeve apo aseteve publike. Por, natyrisht kjo ndodh kur pushtetarët duan të dëgjojnë dhe të kuptojnë, pra kur kanë minimumin e përgjegjshmërisë qytetare, në të kundërt shurdhëria dhe verbëria do të na ndjekin si mallkim. Ajo që evidentohet rëndom në qeverisjet tona të kahershme është pikërisht veprimi ose mosveprimi në kushtet e një terri informativ. Perse fshihet nga publiku dhënia e informacionit, shpjegimi i arsyeve, avantazhet ose disavantazhet e prishjes apo mosprishjes? Ndoshta të tjera të vërteta ka përkundrejt atyre që thuhet nën tryshinë e presionit qytetar, ose qeveritarët tanë nuk e ndjehin të nevojshme llogaridhënien, sepse për ta ne jemi thjesht një turmë që ecën kuturur si dele të bindura dhe duke u marrë me ne, ndoshta u ulët "inteligjenca" e tyre e tepruar, ose ndoshta të vërtetat nxjerrin në pah dritëhijet e veprimeve korruptive të këtij virusi, që ka kapur si epidemi të gjitha hallkat e qeverisjes lokale dhe qendrore.

Por, nuk është vetëm çështja e Teatrit Kombëtar, e cila është mbytur nga errësira informative. Përmbytja e Bibliotekës Kombëtare është një tjetër ngjarje e ndodhur së fundmi. Kjo ngjarje është ulëritëse për një komb. Ndërsa shihja se si vareshin nëpër tela librat, apo kur thaheshin faqet e zhubrosura me tharëse flokësh, ndjeva një keqardhje që më shponte shpirtin. Në ato tela nuk shihja librat që vareshin, por shpirtin e qindra dhe mijëra autorëve dhe shkrimtarëve, të cilët nuk e kanë imagjinuar kurrë që veprat e tyre, historia dhe memoria të përfundonte në ato pamje mjerane. Si mundet që tempulli i vetëm i dijes në vendin tonë të përfundojë në atë gjendje, ku librat të varen si rrecka të grisura. Askush nuk foli, askush nuk mori përgjegjësinë, vetëm hesh-

tja bërtiste. Ne nuk i meritojmë as përpjekjet e të parëve, ne nuk meritojmë as sakrificat e tyre, as përpjekjet që ata kanë bërë për ta ruajtur këtë vend nga asimilimi i çdo forme. Ne jemi të aftë vetëm të shkatërrojmë, nuk dimë as të ruajmë dhe as të trashëgojmë asnjë vlerë, asnjë thesar. Një vend, të cilin i shkatërrohet dija, kultura, memoria historike, arsimi, ai nuk mund të ekzistojë me. Keqardhje për të gjithë ata që jo kontribuojnë me dashje në shkatërrimin e gjithçkaje për të ndërtuar diçka. Arroganca e pushtetit, heshjtja dhe veprimet arbitrare gjithmonë na kanë vënë para faktete të kryera. Kështu ndodhi për çështjen e plehrave kimike (edhe sot nuk dimë me saktësi të themi, çfarë ndodhi dhe pse), kështu ndodhi për çështjen e kampeve të refugjatëve (se ç'u tha dhe seç nuk u tha, askush nuk di të thotë me saktësi), kështu po ndodh për marrëveshjen e detit (dikush thotë ka marrëveshje, dikush rend ta mohojë). Informacioni ynë sporadik (ndoshta edhe i deformuar, i pasakte... etj.) më shumë sigurohet nga faktori ndërkombëtar, mediat e huaja, intervistat e fëmijëve dhe asnjë fjalë, asnjë informim, asnjë shpjegim nga qeveritarët tanë.

Këto janë ato që duhet të na shqetësojnë ne, jo thjesht çështja e Teatrit Kombëtar, e cila padyshim është shumë e rëndësishme. Por pas saj me siguri do të dalë diçka tjetër dhe kështu historia do të përsëritet në të njëjtën mënyrë. Shqetësimi dhe reagimi qytetar e sidomos intelektual duhet të jetë për mënyrën e qeverisjes, sepse nuk është një rast, nuk është një gabim dhe nuk ka vend as për falje, sikurse bën dondheher kryeministri. Gabimet e përsëritura nuk janë më gabime, janë fajë dhe madje shumë të rënda, të cilat tregojnë se pushteti ka

krijuar një hendek mjaft të madh me popullin, me votuesin, të cilin as nuk e dëgjon me dhe as nuk ndjen asnjë detyrim minimal për ta informuar, pa pretenduar për të marrë mendimin para çdo vendimmarrjeje me rëndësi kombëtare. Mjere kush do të bjerë i pari në këtë hendek...

Parimi i transparencës, kaq shumë i munguar në aktualitetin shqiptar, është parimi bazë për një qeverisje të mirë në çdo shtet demokratik. Kjo nënkupton "shkëmbimin e informacionit dhe veprimin në një mënyrë të hapur".

Respektimi i këtij parimi nxit angazhimin qytetar dhe kjo nënkupton një pjesëmarrje aktive të tyre në çdo vendimmarrje. Ndoshta është pikërisht ky, përfitimi për publikun, është ajo çka i tremb më shumë qeveritarët tanë. Transparenca nuk ndihmon vetëm në informimin e publikut në lidhje me zhvillimin e ideve dhe propozimeve, por edhe për të bindur qytetarët se agjencitë publike janë të interesuara në dëgjimin e zërit të tyre, të pikëpamjeve të tyre dhe u përgjigjen prioritetëve të qytetarëve. Pikërisht respektimi i këtij parimi si detyrim moral dhe ligjor rrit legjitimitetin e procesit të vendimmarrjes dhe forcon "demokracinë e drejtpërdrejtë". Nëse kjo do të respektohet me vërtetësi, nëse shqetësimi qytetar do t'i përgjigjet zëri i arsyes, nëpërmjet informimit dhe shpjegimit të ideve dhe planeve, të gjithë jemi të interesuar për një jetë më të mirë, më cilësore dhe për një zhvillim urban, që i përgjigjet modernitetit, duke ruajtur vlerat dhe trashëgiminë kulturore, duke ndërthurur bukur të shkuarën me të tashmen, për t'u trashëguar brezave traditën dhe kulturën identitare.

Prof. Asc. Dr. Rezana Konomi  
Kolegji Universitar "Luarasi"

## HOROSKOPI

### DASHI

Plutoni ndodhet në qiellin tuaj dhe shfaq një mirëkuptim me Hënë, që në punë të zhblikohet situata. Rezultatet nuk do të vonojnë. Disa persona ju bëjnë të ndërrojnë për aventura, por nuk jeni i sigurt nëse bëjnë për ju.

### DEMI

Do të keni prije për t'u mbyllur brenda vetes për të rrëmuar në të kaluarën. Por do të merrni në konsideratë edhe mundësinë e së tashmes. Kontakti me persona të veçantë do t'ju hapë horizonte të reja dhe do t'ju japë mundësinë të përmirësoheni.

### BINJAKET

Me ndikimin e Jupiterit mik do të dini të menaxhoni një çështje të ndërlikuar në punë. Do të dini fitimtarë si edhe me një mundësi të mirë për të ardhmen. Dëshira juaj për ëmbëlsi dhe dialog do të kuptohet menjëherë nga partneri.

### GAFORJA

Do të kaloni pengesat dhe do t'ia dini më në fund të vini në zbatim një ide që e keni lënë mënjane prej kohësh për shkak të pasigurive. Një takim i papritur do t'ju shtrëngojë që të përballeni me probleme të hershme dhe t'i zgjidhni ato.

### LUANI

Mos u gjëni nga shkëlqimi i një momenti pasioni që bën që t'ju rrahë fort zemra, sepse mund të dalë se është krejt ndryshe nga sa duket. Pozicioni i Hënës me Saturnin në qiellin tuaj bën që të keni pak dëshirë të angazhoheni. Përqipni të jeni më i gatshëm.

### VIRGJERESHA

Me Hënë që përqafon Plutoni do të ndiheni të sigurt nga një frymë praktikiteti dhe nga largpamësia në investime dhe në projekte. Keni dëshirë të jetoni në thellësi të shpirtit, atë që deri më tani e keni jetuar në nivel të mendjes.

### PESHORJA

Kujdes nga çështjet që kanë të bëjnë me financat, sepse mund të shkaktohen vonesa dhe pengesa. Më mirë të merreni vetë me këto gjëra. Shqetësimi në fushën e dashurisë, për shkak të Venusit kundra, mund të bëjë që të merrni vendime gjaknxehta.

### AKREPI

Për shkak të Neptunit armiqësor, është e rëndësishme të vlerësoni me qartësi gjendjen tuaj. Mund të mbeten të qndur, por nuk është koha për zvarritur gjërat. Dashurioni dhe jetoni në mënyrë madhështore, por duhet të mos haroni se jeta ka edhe gjëra të vogla që duhen bërë.

### SHIGJETARI

Mos lejoni askënd që t'ju pengojë në realizimin e një projekti që e keni për zemër. Duhet ta mbrori me vendosmëri. Do të ndiheni të mbrojtur dhe të rrethuar nga miq që ju duan dhe ju gmojnë, pa kërkuar asgjë në këmbim.

### BRICJAPI

Në dashuri lëni mënjane sedrën dhe lojërat e pushtetit. Eeni përpara, kush ju tërheq vëmendjen dhe ju intereson, do t'ju ndryshojë me butësi. Do të keni mosmarrëveshje me njerëz që nuk shkonin mirë dhe nuk keni ndër mend të duroni provokimet e tyre.

### UJORI

Parashikohen ndryshime. Për momentin mos merrni vendime të prera, që mund të mos jenë më pas të duhurat. Prisi sa të qartësohen gjërat. Mos bini për e tundim të reaguuar menjëherë, sidomos në punë. Rrezikoheni nga shpërqendrimet.

### PESHQIT

Me ndikim pozitiv të Hënës do të keni harmoni në marrëdhëniet në familje. Nëse keni fëmijë apo nipër, do të arctoheni pa fund duke luajtur me ata. Raporti me partnerin në përgjithësi është i mirë, edhe pse ka pika ku nuk keni mirëkuptim.

Rubiales po e mendon seriozisht

Spanja, a ka ardhur koha për revolucion?



Eliminimi i Spanjës ka sjellë edhe tronditjen e dytë të iberikëve në harkon kohor të katër viteve, dy dështime radhazi dhe dy përgjegjësi të mëdha për spinën e kujtdo në federatën spanjolle. Një dështim i cili e ka zanafillën që në të njëjtën periudhë të katër viteve më parë, atëherë kur Spanja e Del Boskes dështoi të kalonte fazën e grupeve, ndonëse në vitin 2010 ishte kurorëzuar si më e

mira e planetit në Afrikën e Jugut, pika kulmore e një skuadre që tiki-takën e kishte kthyer nga art në armë vrasëse. Në Rusi "Furia Roha" e nisi shembjen ende përpara se të zbriste në fushën e lojës. Presidenti i Federatës Spanjolle, Luis Rubiales, shkarkoi dy ditë përpara se të startonte evenimenti trajnerin Julen

Lopetegui për shkak se Reali i Madridit vendosi të lajmërojë emërimin e tij në krye të stollit të "Los Blancos", një thyerje etike, një arrogancë e madrilenëve, që nuk u pëlqeu aspak zyrtarëve të federatës që larguan brenda pak orëve arkitektin e asaj që në gadishull cilësohej si rilindja e përfaqësueses iberike. Në vend të tij

u emërua Fernando Hierro, ish-kapiteni i Spanjës dhe Real Madridit, që në përfaqësues mbulonte rolin e drejtorit teknik. Një ndryshim, të cilin koha e vërtetoi si një dështim total. Madje, nën zë, u tha se federata spanjolle ishte e gatshme të përballonte dështimin dhe jo turpërimin që i bëri Reali i Madridit, duke

mos e respektuar federatën në publikimin e kontratës me trajnerin e Spanjës. Sot në Spanjë përfaqësuesja nuk ka një trajner. Legjendat e së shkuarës kanë deklaruar cikël të mbyllur dhe janë tërhequr nga kombëtarja, ndërsa Rubiales duhet të mendojë projektin e së ardhmes, një e ardhme që duket se do të mbyllë përfundimisht kapitullin e të famshmes tiki-taka.

Francë-Belgjikë dhe Angli-Kroaci, finalistja një enigmë, skuadrat të gjitha të forta

Gjysmëfinalet, emocione dhe spektakël na presin

Nga Mbape te Hazar, nga Kejn te Modriç. Fitimtari, një rebus



Jeton Selimi

Francë-Belgjikë pritet të jetë një sfidë e jashtëza konshme, një sfidë e cila premtion spektakël pavarësisht se luhet në gjysmëfinale të Kupës së Botës, një sfidë që pikësepari luhet për t'u mos humbur. Përballë janë dy skuadrat me ofensivën më të bukur në këtë Botë: Mbape-Grizman, kundër Lukakut, Hazard e De Bryjn. Franca vjen në këtë gjysmëfinale pasi likuidoi Argentinën e Mesit dhe arriti të thyente strukturën e hekurit të Uruguait, është nga të paktat skuadra gjysmëfinaliste, e cila respektoi çdo parashikim duke kaluar aty ku i takon. Trajneri Didier Deshamp mund t'i gëzojë faktin se ka në dispozicion një skuadër, e cila pavarësisht se është e mbipopulluar me yje, nuk është e varur tek individët. Nëse nuk shkëlqen Mbape, e bën Grizman si në takimin e fundit kundër Uruguait, apo e kundërta. Franca duket një skuadër me e balancuar se Belgjika, vjen në këtë gjysmëfinale me 9 gola të shënuar dhe 4 të pësuar. Duetet e drejtpërdrejta në të kaluarën flasin në favor të "gjelave" francezë, të cilët mes botërorëve dhe europianëve



nuk kanë humbur kurrë përballë "djajve të kuq", por fakt është se Hazar me shokë treguan edhe ndaj Brazilit se kanë ardhur në Rusi për t'i



shkuar deri në fund këtij turneu. Belgët i kanë të gjithë kartat e dhura për të triumfuar në Rusi. Trajneri Roberto Martinez ka në dispozicion një

sulm të frikshëm, i udhëhequr nga një gjigant si Romeo Lukaku por mbi të gjitha ka një mesfushë me shumë fantazi, lojtarë si Hazard, Dris Mertens apo De Bryjn, futbollistë, të cilët jo vetëm janë të magjishëm me topin në këmbë, por kanë një marrëdhënie të mirë me golin. Belgjika vjen për herë të parë në një gjysmëfinale Botërore, duke kanë shënuar 14 gola dhe pësuar 5. Franca-Belgjikë është një sfidë, e cila nuk pritet të luhet vetëm në sulm, pasi as mbrojtja e tyre nuk stonon, Tibo Kurtua dhe Hugo Loris janë mishërimi i një reparti që është po aq i bukur, pritet e tyre në këtë Botëror kanë pasur po aq rëndësi sa golat e Lukakut e Grizman.

**ANGLI-KROACI**  
Angli Kroaci është një përballje sa enigmatike, aq edhe e bukur për t'u parë. Dy filozofi kretjesisht të kundërta, dy ekipet që gjithnjë vitet e fundit janë futur në garë me shumë bujë, por me po aq bujë kanë dalë shumë shpejt. Thjesht fakti që "tre luanët" rikthehen në gjysmëfinalet e një Botërori pas 28 vitesh e konfirmon një gjë të tillë. Anglia dhe Kroacia kanë të përbashkët faktin që të dyja janë ekupe fizike, skuadra të cilat e kanë mbështetur lojën e tyre në një mesfushë të hekurit dhe mbrojtës tipik. As Anglia e as Kroacia nuk kanë individë që ndriçojnë më shumë se sa të tjerët, ose më saktë nuk e kanë të përqendruar lojën e tyre tek individët, por

te grupi. Sigurisht kur sheh që në fushë do të zbrisin lojtarë si Modriç, apo Herri Kejn e kupton që yjet jo vetëm që nuk i mungojnë, por janë të shumtë. Anglia ka në dispozicion golashënuesi më të mirë në këtë Botëror, Herri Kejn, por kapiteni duket i shkëputur në majën e sulmit, të paktën në dy takimet e fundit, ku ka pasur pak ose aspak rastet të pastra. Trajneri Sauthgeit nuk duket të shqetësohet për këtë fakt në një kohë kur ka në dispozicion shumë lojtarë të tjerë që mund të dërgojnë topin në rrjetë, si Dele Ali apo Mekuajër, dy shënuesit në sfidën kundër Anglisë. Një mesfushë me shumë muskuj dhe me mbrojtës ekspertë, Anglia duket se është kthyer në orgjinë, pasi 8 nga 11 golat e shënuar në këtë Botëror janë realizuar me kokë. Kroacia i sfidon në këtë gjysmëfinale me dy nga mesfushorët më të mirë në qarkullim, Luka Modriç dhe Ivan Rakitiç, por armata e trajnerit Zlatko Dalic plotësohet nga futbollistë si Mario Manxukic, Ivan Peric, futbollistë të klasit botëror që mund të zgjidhin ndeshjen në çdo moment. Mbape i vetmi plus që Anglia ka në këtë përballje është freskia fizike, pasi kundërshtari i tyre dy ndeshjet e fundit i ka luajtur deri në shtesë, por duket të kenë kujdes nëse sfida përfundon në penallti, Kroacia ka treguar se është skuadër eksperte.

Mesfushori, në qendër të kritikave

Babai këshillon Ozilin: Largohu nga Gjermania

Gjermania rezultoi një dështim në Botërorin e Rusisë, pasi u eliminua që në fazën e grupeve. Sigurisht që një rezultat i tillë nuk mund të kalonte pa shumë polemika dhe faktorët janë duke u kërkuar për të zgjidhur këtë çështje. Një nga futbollistët më të kritikuar në kohët e fundit ishte edhe mesfushori i Arsenalit, Mesut Ozil. Performanca e zhvilluar nga ana e tij në Rusi ka qenë në një nivel të ulët, aq sa edhe Lëv e ka ulur në stol në një moment. Babai i Mesut Ozilit, Mustafa Ozil, i ka kërkuar mesfushorin të largohet nga Gjermania, pasi po i faturojnë të gjithë krizën. "Nëse unë do të isha në vendin e tij, do të largohesha. Të tjerët nuk e kanë kuptuar mirë krizën dhe ata që thonë se Mesut Ozili do të ishte më mirë të mos mblidhej, kjo është një shaka e rëndë e tyre. Gjithmonë thuhet se fitorja u përket të gjithëve, por nëse humb, ti humbet nga faji i Ozilit?", ka thënë Mustafa Ozil për "Sport Bild".

"TOPI I ARTË"

Kupa e Botës i jep fund dominimit

Ronaldo-Mesi

Pas një dominimi 10-vjeçar të Ronaldos dhe Mesit, duket se gara për "Topin e Artë" është më e ndezur se kurrë. Pavarësisht faktit se ngelen ende disa muaj, një dorë të madhe në dhënie e këtij çmimi i jep padyshim edhe Botërori. Pikërisht të ky i fundit kanë dështuar edhe protagonistët absolutë të "Topit të Artë", dy yjet që kanë pushtuar prej shumë kohësh botën e futbollit, pasi Ronaldo është eliminuar me Portugalinë dhe Mesi me Argentinën. Tashmë vëmendja është e përqendruar të futbollistë


të tjerë, të cilët janë duke e vazhduar aventurën e tyre në turneun që po zhvillohet në Rusi. Luka Modriç është një prej favoritët kryesorë të këtij çmimi, pasi fitimi i "Champions League" dhe arritja të paktën në gjysmëfinalen e Botërorit me Kroacinë, i jep atij pikët e mjaftueshme për të kryesuar listën. Më pas janë edhe dy yjet francezë, të cilët kanë shkëlqyer dhe bërë diferencën sa herë kanë mundur në fushën e lojës. Grizman nga njëra anë me sezo-

nin e tij të Altetiko Madridi dhe me paraqitjen në Botëror, ndërsa Mbape në tjetrën, që pavarësisht se PSG nuk ka marrëdhënie të mira me "Champions League", gjithmonë arrin ta diferencojë veten nga të tjerët. Një tjetër yll i ri ka lindur në Angli dhe ai është padyshim Herri Kejn. Pas një sezoni fantastik me Tottenhamin, këtë herë sulmuesi anglez është pretendenti kryesor për t'u shpallur si golashënuesi më i mirë i Botërorit, por edhe një nga

favoritët edhe për të fituar "Topin e Artë". Nëse Belgjika do të arrinte në majën e suksesit në Rusi, duke e fituar Botërorin, atëherë do të ishin tre emra të mundshëm belgë që mund t'i shtoheshin listës. Hazard, De Bryne dhe Lukaku, këta janë lojtarët që kanë arritur të bëjnë veçoren jo vetëm në Rusi, por edhe në klubet e tyre europiane ku ata aktivizohen. Por për të dalë në një përfundim më të saktë, duhet të presim për të zbardhur emrin e fituesit të turneut që është



**Fjalëkryqi (1)**



35. Martin i Norma Rae.  
36. Mund të jenë filmi.  
38. Një jepet për hartim.  
39. Ami i Maupassant.  
41. Fundi i Turandot.  
42. Halli këngëtare.  
45. Neilli i Jurassic park.  
47. Pineda e Garcia Lorca-s.  
48. Giorgio stilist
- VERTIKAL**  
1. Morisette këngëtare.  
2. Kilmer aktor.  
3. Heche aktore.  
4. Fillojnë tatëpjetën  
5. Eshhtë diapozitiv shumë i ndjeshëm.  
6. Mbyllin spitale.  
7. Në krye të masave.  
8. Bëjnë shirit me shi.  
9. Qe vajza e Tantalit.  
10. Janë më shumë se dëshira  
12. Ishte dekret i sulltanit.  
15. Qe mbreti i urtë i Pilos.  
16. Quinn aktor.

**HORIZONTAL**

1. Pupi regjisor.  
5. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve  
11. Turner aktore.  
12. Fillojnë festat.  
13. Skuadër greke.  
14. Falen pa fe.  
15. U shkrua nga Gorkij.  
18. Një sferë për... model.  
19. Janë bisha.  
22. Parashtesë për dy.  
23. Demoni që persekutonte Sarën.  
24. Stacion i famshëm orbital.  
25. Mendes regjisor.  
27. Një rreth i ngushtë miqësor  
29. Film me Robert de Niro dhe Jean Reno  
30. Këndohen në opera.  
32. Eshhtë lajm i vjetër.  
34. Sharif aktor.

17. Gasol i NBA.  
20. Fillojnë garën.  
21. Një pjesë e reformave.  
26. Eshhtë si biskotë.  
28. Mund të jetë karmelitan.  
29. Sjellin shi.  
30. Bel i Maupassant.  
31. Direk pa ekstreme.  
33. Gjysma e bimëve.  
34. Mbyllin një motor.  
36. Eshhtë bitum.  
37. Fara këngëtare.  
38. Hanks aktor  
39. Stiller aktor.  
40. Morrison rockstar.  
42. Fillojnë masat.  
43. Në krye të tabelës.  
44. Dorisa janë në fund.  
46. Fund filmi.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Film i hitchcock.  
6. Fillojnë premierën.  
7. Janë legjendat.  
11. Kush ka... ka zët.  
12. Thurman aktore.  
15. Një pjesë e testamentit  
16. Një pjesë e studimeve.  
18. Kështu është situata e tensionuar.  
21. Telefoni në kartvizitë.  
22. Eshhtë ngasje.  
24. Në krye të autoriteteve.  
25. Mbyllin mbledhjen.  
26. Pason abetaren.  
29. Fillojnë aafrimin.  
30. Cocker këngëtar.  
31. Bartok kompozitor.  
33. Tiriac që qe tenist.

**VERTIKAL**


35. Oxa këngëtare.  
36. Kalimi në ekstreme.  
37. U shkrua nga Zola.  
39. Fise pa fe.  
40. Eshhtë mballomë.  
41. I mungon apatikut.  
43. Një pjesë e medaljeve.  
44. Një këngëtar lirik.  
46. Pak torturuese.  
48. Ka privilegjin e jetës.  
51. I famshmi Pacino.  
52. Nasi shkrimtar.  
53. Janë temperaturat më të ulëta.  
54. Me pit në box.
- VERTIKAL**  
1. Janë enigmatikë.  
2. Emri i Vivaldit.  
3. Rrjedh në klepsidër.  
4. Iniciallet e Selleck aktor.  
5. Fillojnë rubrikën.  
6. Ishte babai i Prokinit dhe Filomelës.  
8. Vitet pa kufij.  
9. Mbyllin kanate.  
10. U shit për një pjatë thjerza.  
13. ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.  
14. Moore aktore.  
17. Rocca aktore.  
19. Janë përmasa.  
20. Fund dhjetori.  
23. Mbyllin krahum.  
26. Fillojnë kalimin.  
27. Duhet ruajtur.  
32. Ishte Europa komuniste.  
34. Agjenci Kombëtare Lokale  
38. Berg kompozitor.  
40. Të parat në Amsterdam.  
42. Elsa këngëtare.  
45. Memoria në computer  
47. Me të nxjerrin trarë.  
49. Në mes të dhomës.  
50. Ekstreme kateti.  
52. Kufijtë e lutjes.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			9		6			
		8	1				5	9
9	7	1	5					4
8					1	4		
		7			5	3		
				4				
2	9		8		6	7		
6		5	7					
	8			5				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

3	2	1	9	8	6	4	5	7
4	5	8	1	3	7	2	6	9
9	6	7	5	4	2	3	8	1
8	7	3	2	6	1	5	9	4
1	4	2	3	5	9	6	7	8
5	9	6	4	7	8	1	2	3
6	8	4	7	1	5	9	3	2
7	1	9	6	2	3	8	4	5
2	3	5	8	9	4	7	1	6

*Argëtim filozofik*

- Errësirën e njërit, dy së bashku e bëjnë dritë!

- Çelësi i marrëdhënieve është i thjeshtë. Nëse shtrembërohet qoftë edhe një herë .... nuk do ta rihapë të njëjtën derë.

- Nuk them se nuk besoj në një mundësi të dytë. Thjeshtë them se nuk besoj se të gjithë e meritojnë!



*Thënie të mençura*

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11	18	3	10	18	2	1	15	20	E	P	O	S	M	P	L				
3	2	6	5	3	2	1	5	1	13	1	R	E	T	E	V	A	R	I	A	N	T
21		4	3	5	6	2	1	5	5	10	E	L	I	T	E	N	I	S	T	E	T
1		6	10	1	2	8	11	6	4	1	N	E	K	A	P	I	T	U	L	L	I
2	13	7		2	1	5	1		1	2	D	M	I	U	R	A	S	E	S		
	19	1	7	3	5	6		15	14		E	A	L	L	A	K	U	T	O	T	
13	3	5		2		5	6	11	1		K	A	M	A	T	E	T	I	N	O	
5	2					21		19	6	2	E	A	S	E	N	T	I	T	R	K	P
1	5	7		6	2	8	5	10	8	6	V	A	R	T	I	I	R	A	N	I	
16	8	7	8	17	6	5		1	6		A	L	T	E	M	I	L	E	D		
6			15	8	5	1	5			18	R	O	J	E	T	K	E	N	D	E	T
4	3	18	8	7	6			18	6	4	I	N	E	S	P	A	I	N	R	I	

- - Më keq se të flasin keq për ju është që të mos flasin fare për ju.
- - Eshhtë e rëndësishme të bësh dikë të lumtur, dhe është e rëndësishme për të filluar me veten.
- - Heshnja dhe buzëqeshja janë dy fjalë të rëndësishme. Me një buzëqeshje mund të zgjidhësh shumë probleme, me heshjen mund të shmangësh shumë probleme.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

